

A 320.

2.(3)

J 1911

LIBRARY OF THE  
Massachusetts  
Bible Society

Catalog No. A 320 . 2 (3) / J . 1911  
Family INDO . EUROPEAN  
Sub-Family THRACO-ILLYRIAN  
Branch ILLYRIC  
Group -  
Language ALBANIAN  
Dialect TOSK , UNION (Romanized)  
Locality Albanic  
Contents JOHN  
Version  
Translator  
Published by  
Place MANASTIR  
Date 1911  
Accession No. 458  
Accession Date May 14 1930  
Price sample

THE

# THIRD OF MAY

1880

1880

1880

1880

1880

1880

1880



UNGJILLI  
PAS JOANIT

Kthyerë prej Elinishtesë

Shqip

Ndë të folë Toskënisht



MANASTIR

Shtypëshkronja Treg. Nërkombëtare

1911



# Ungjilli pas Joanit.

## Krye 1

- 1 Që përpara herësë ishte Fjala, edhe Fjala  
ishte me Perëndinë, edhe Fjala ishte Perëndi,  
2 Këjo ishte që përpara herësë me Perëndinë.  
3 Të-gjitha u bënë me anë t' asaj; edhe pa  
atë nuk' ubë as ndonjë *gjë* që është bërë.  
4 Nd' atë ishte jetë, edhe jeta ishte drita e  
5 njerësvet. Edhe drita ndrit nd' errësirët, edhe  
errësira nuk' e kupëtoj.
- 6 Qe *një* njeri dërguarë nga Perëndia, i-  
7 cili e *kishte* emërinë Joan. Ky erdhi për dësh-  
mim, që të apë dëshmim. Dritënë, që të be-  
8 sonjënë të-gjithë me anë t' ati. Ay nuk' ishte  
Drita, po *qe dërguarë* që të apë dëshmim  
për Dritënë.
- 9 Ishte Drita e-vërtetë, që ndrit çdo njeri,  
10 kur vjen ndë botët. Ishte ndë botët, edhe  
bota ubë me anë t' ati; po bota nuk' e njohu  
11 atë. Erdhi ndë të-tijt, edhe të-tijtë nuk' e  
12 pritnë atë. Edhe sa e pritnë, atyre u dha  
pushtet të bënenë bij Perëndie, atyreve që  
13 besonjënë me anë t' ati; Ata nukë lintnë  
brej gjakesh, as prej dashurimi mishi, as  
prej dashurimi burri, po prej Perëndie.

- 14 Edhe Fjala ubë mish, edhe ndënji ndër  
ne, (edhe pamë lavdin' e ati, lavdi posi të-  
vetëmlinduri prej Atit,) plot me hir e me të-  
vërtetë.
- 15 Joani ep dëshmim për atë, edhe bërtiti, dy-  
ke thënë, Ky është ay për të-cilinë thashë,  
Ay që vjen pas meje është më i-math se unë,  
sepse ishte përpara meje.
- 16 Edhe të-gjithë ne muarmë prej të-mbushu-  
17 rit t' ati, ethe hir ndë vënt hiri. Sepse  
nomi udha me anë të Moisiut, po hiri edhe  
18 e-vërteta ubë me anë të Jisu Krishtit. As-  
ndonjë kurrë s' e ka parë Perëndinë; veç i-  
Uetëmlinduri Bir, që është ndë gjit të Atit  
ay *na* e dëfteu.
- 19 Edhe ky është dëshmimi i Joanit, kur  
dërguanë Judhenjtë nga Jerusalmi priftër edhe  
20 Levitër që t'a pyesënë, Gili je ti? Edhe  
rrëfeu, edhe nukë mohoj; edhe rrëfeu, Se  
21 unë nukë jam Krishti. Edhe e pyetnë Çë pra?  
Jlia je ti? edhe thotë, Nukë jam. Profiti je ti?  
22 edhe upërgjeq, Jo. I thanë pra, Cili je? që t'  
u përgjigjemi atyreve që na kanë dërguarë?  
23 ç' thua për vetëhenë t'ënde? Tha, „unë *jam*  
zër' i ati që bërtet ndë shkretëtirët, Drej-  
toni udhën' e Zotit.“ sikundrë tha profiti Isai.
- 24 Edhe ata që qenë dërguarë ishinë prej  
25 Farisenjet; Edhe e pyetnë e i thanë, Përse  
26 pra pagëzon, kur nukë je ti Krishti, as Ilija,  
as profiti? Joani u upërgjeq atyrë, dyke thë-



në, Unë pagëzonj me ujë; po ndër mest t'  
27 uaj rri ay që ju nuk' e njihni; Ay është ay  
që vjen pas meje, i-cili është më i-math se  
unë; të-cilit unë s' jam i-zoti t' i s'gith rripin'  
28 e shollësë. Këto ubënë ndë Uithavara përtej  
Jorthanit, *atje* ku ishte Joani dyke pagëzuarë.

29 Ndë të-nesërmet Joani sheh Jisunë dyke  
ardhurë tek ay, edhe thotë, Na Qëngji i Pe-  
30 rëndisë, që ngre fajin' e botësë. Ky është ay,  
për të-cilinë unë *u* thashë, *se* Pas meje vjen  
një burre, i-cili është më i-math se unë, se-  
31 pse ishte përpara meje. Edhe unë s' e njo-  
ha; po që të dëftenetë ndë Israilt, përandaj  
erdha unë dyke pagëzuarë me ujë.

32 Edhe Ioani dha pëshmim, dyke, thënë, Se  
pashë Frymën' *e-Shënjtëruarë* dyke sbriturë  
nga qielli posi pëlump, edhe ndënji mbi atë.  
33 Edhe unë nuk' e njoha; po ay që më dërgoj të  
pagëzonj me ujë, ay më tha, Ay përmbi të-  
cilinë të shohç Frymën' *e-Shënjtëruarë* dyke  
sbritur' e dyke ndënjurë mbi atë, ky është ay  
34 që pagëzon me Frymë të-Shënjtëruarë. Edhe  
un' e pashë, edhe dhashë dëshmim, se ky  
është i Bir' i Perëndisë.

35 Ndë të-nesërmet përsëri Joani ishte dyke  
36 ndënjurë, edhe dy prej nxënëset të ti; Edhe  
kur shtyri sytë e pa Jisunë dyke ecurë, thotë,  
37 Na Qëngji i Perëndisë. Edhe të dy nxënësitë  
dëgjuanë atë dyke folurë, edhe vanë pas Ji-  
38 sujt. Edhe Jisuj kur ukthye, edhe pa ata dyke

- vaturë pas ati, u thot' atyre, Ç' kërkoni?  
39 Edhe ata i thanë, Ravvi, (që e-kthyerë do  
40 me thënë, Mësonjës,) ku e ke të-ndënjuritë?  
41 U thot' atyre, Ejani ethe shihni. Erthnë edhe  
panë ku e kishtë të-ndënjuritë; edhe mbetnë  
përan' ati atë ditë; edhe ora ishte sindonja  
dhjetë.
- 42 Andhreu, i vëllaj i Simon Pjetrit, ishte një-  
ri nga ata të dy që dëgjuanë prej Joanit  
43 për atë, edhe vanë pas ati. Ky më përpara  
gjen të vëllan' e ti Simoninë, edhe i thotë,  
gjetmë Messinë, që e-kthyerë domethënë Kri-  
44 shti. Edhe e pruri te Jisuj. Edhe Jisuj shtyri  
sytë mb' atë, edhe tha, Ti je Simoni, i bir' i  
Jonajt; ti dotë quhesh Qifa, që e-kthyerë do  
methënë Pjetër (gur).
- 45 Ndë të-nesërmet Jisuj deshi të dalë ndë  
46 Galilet; edhe gjen Filipinë, e i thotë, Eja pas  
meje. Edhe Filipi ishte nga Uithsaidhaja,  
nga qyteti i Andhreut edhe i Pjetrit.
- 47 Filipi gjen Nathanailinë, edhe i thotë;Ke-  
mi gjetur' atë që shkroj Moisiu ndë nomt,  
edhe profitëritë, të birin' e Josifit që është  
48 nga Nazareti. Edhe Nathanaili i tha, Amunt  
të dalë ndonjë gjë e-mirë nga Nazareti? Fi-  
49 lipi i thotë, Eja edhe shih. Jisuj pa Natha-  
nailinë dyke ardhurë tek ay, edhe thotë për  
atë, Shih një Israilit me të-vërtetë, tek i-cili  
50 gënjeshtërë nukë ka. Nathanaili i thotë, Që  
ku më njeh? Jisuj upërgjeq e i tha, Para se

të të thërresë Filipi, kur ishnje ndënë drut  
 51 të fikut, *unë* të pashë. Nathanaili upërgjeq e  
 i thotë, Ravvi, ti je i Bir' i Perëndisë, ti je  
 52 mbreti i Israilit. Jisuj upërgjeq e i tha, Sepse  
 të thashë, *se* Të pashë ndënë drut të fikut  
 beson? dotë shohç më të mëdha se këto.  
 53 Pastaj i thotë, Me të-vërtetë, me të - vërtetë  
 po u them juve, Që ndashti e paskëtaj dotë  
 shihni qiellinë të-hapurë, edhe ënqjëjt' e Pe-  
 rëndisë dyke hipur' e dyke sbriturë mbi të  
 Birin' e njeriut.

### Krye 2.

1 Edhe të-tretënë ditë ubë dasmë ndë Ka-  
 na të Galilesë; edhe e ëm' e Jisujt ishte a-  
 2 tje. Edhe uftua ndë dasmët edhe Jisuj edhe  
 3 nxënësit' e ati. Edhe si umbarua vera, e ëm'  
 4 e Jisujt i thotë, Verë s' kanë. Jisuj i thotë, Ç'  
 ke ti me mua, o grua? ora ime edhe s' ka  
 5 ardurë. E ëm' e ati u thotë shërbëtorëvet,  
 6 Bëni ç't'u thotë juve. Edhe atje ishinë gja-  
 shtë enë të gurta vënë për të pastruarëtë  
*pas zakonit* të Judhenjvet, që nxininë sicila  
 7 nga dy a tri masa. Jisuj u thot' atyre, Mbu-  
 8 shni enëtë më ujë. Edhe *ata* i mbushnë gjer  
 sipërë. Pastaj u thot' atyre, Nxirni ndashti,  
 edhe shpini të-parit të mësallësë. Edhe *ata*  
 9 shpunë. Edhe i-par' i mësallësë si ungërua  
 ujëtë që ishte bërë verë, edhe nukë dinte  
 nga është, (po shërbëtorëtë që kishinë nxje-

- 10 rrë ujëtë e dinine,) i-par' i mësallësë thërrret dhëndërrinë, Edhe i thotë, Çdo njeri më përpara nxjer verën' e-mirë, edhe si të dehenë, atëhere *nxjer* të-poshtërënë; *po* ti ke ruajturë verën' e-mirë gjer ndashti.
- 11 Këta të-nisurit' e çudiravet Jisuj e bëri ndë Kana të Galilesë, edhe çfaq i lavdin' eti; edhe nxënësit' e ati i besuanë.
- 12 Pastaj sbriti ndë Kapernaum, ay edhe e ëm' e ati edhe të Vëllezërit' e ati, edhe nxënësit' e ati; edhe mbetnë atje jo shumë dit.
- 13 Edhe pashka e Judhenjet ishte afërë, edhe Jisuj hipi ndë Jerusalem.
- 14 Edhe gjeti ndë hieroret ata që shisninë qe e dhën e pëllumba, edhe truvezarëtë dyke
- 15 ndënjurë. Edhe si bëri një fruskullë, tërkuzësh, i nxori të-gjithë nga hieroreja, edhe dhëntë edhe qetë; edhe derdhi asprat' e truvezarëve,
- 16 edhe truvezat' i përmbysi; Edhe atyreve që shisninë pëllumbatë u tha, Ngrini këto këtej; mos bëni shtëpin' e t' im Et shtëpi tre-
- 17 gëtie. Atëhere u ra ndër mëntt nxënëset t' ati se është shkruarë "Zilia për shtëpinë t' ende më hëngri.,,
- 18 Judhenjtë pra upërgjeqnë e i thanë, Ç'
- 19 shënjë na dëften që bën këto? Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Prishni këtë tempull, edhe për tri dit dot'a ngre.
- 20 Edhe Judhenjtë thanë, Ky tempull është ndërtuarë ndë dyzet e gjashtë vjet, e ti dot'a

21 ngresh atë për tri dit? Po ay thoshte  
22 për tempullin' e trupit të ti, Kur ungjall pra  
prej së-vdekurish, u ra ndër mëntt nxënë-  
set t'ati, se *për* këtë u thoshte atyre: edhe i  
besuanë shkronjësë, edhe *asaj* fjalësë që u  
tha Jisuj.

23 Edhe kur qe ndë Jerusolim për të-krem-  
ten' e pashkësë, shumë *veta* besuanë mbi  
24 emërit t' ati, dyke vështruarë çudirat' e at'  
që bënte. Po vetë Jisuj nuk' u zinte besë a-  
25 tyre, sepse i njihte të-gjithë; Edhe sepse s'  
kishte nevojë që t' i epte *ati* dëshmim ndonjë  
për njerinë, sepse e dinte ç' ishte për brën-  
da njeriut.

### Krye 3

1 Edhe ishte një njeri nga Farisenjtë, që e  
kishte emërinë Nikodhim, *që ishte* një nga  
2 të-parët' e Judhenjet. Ky erdhi natënë te Ji-  
suj, edhe i tha, Ravvi, e dimë, se nga Pe-  
rëndia ke ardhurë Mësonjës; sepse asndonjë  
s' munt të bënjë këto shënja që bën ti, ndë  
mos qoftë Perëndia bashkë me atë.

3 Jisuj upërgjeq e i tha, Me të-vërtetë, me  
të-vërtetë po të them, ndë mos linttë njeriu  
prej së-larti, s' munt të shohë mbretërin' e  
Perëndisë.

4 Nikodhimi i thotë, Si munt të lintnjë nje-  
riu dyke qënë plak? mos munt të hynjë për së-  
dyti ndë barkt të s' ëmës së ti e të lintnjë

- 5 Jisuj upërgjeq, Me të-vërtetë, me të-vërtetë po të them, ndë mos linttë njeriu prej uji e prej Fryme, s' munt të hynjë ndë mbretërit të Perëndisë. Ç' ka lindurë prej mishit, është mish, edhe ç'ka lindurë prej Frymësë, është frymë. Mos uçudit sepse të thashë, se Duhetë të lintni ju prej së-larti. Era ku të dojë fryn, edhe i dëgjon zënë, po s' di nga vjen, e ku vete; kështu është edhe kushdo që ka lindurë prej Frymësë.
- 9 Nikodhimi upërgjeq e i tha, qysh munt të bënenë këto?
- 10 Jisuj upërgjeq e i tha, Ti je mësonjës' i Israilit, edhe nukë di këto? Me të-vërtetë, me të-vërtetë po të them, se atë që dimë flasëmë edhe për atë që pamë apëmë dëshmim, po dëshmimnë t' ënë nuk'e prisni. Ndë u thashë juve punërat' e dheut, edhe nukë besoni, qysh dotë besoni, ndë u thënça juve punërat' e qiellit? Edhe asndonjë s' ka hipurë ndë qiellit, veç ay që ka sbriturë nga qielli, i Bir' i njeriut, që është ndë qiellit. Edhe sikundrë Moisiu ngriti lart qjarpërinë ndë shkretëtirët, kështu duhetë të ngrihetë lart edhe i Bir' i njeriut; Që të mos humbasë kushdo që t' i besonjë, po të ketë jetë të-përjetëshme.
- 16 Sepse Perëndia kaqë e deshi botënë, sa dha Birin' e ti të-vetëmlindurinë, që të mos humbasë kushdo që t' i besonjë ati, po të ketë jetë të-përjetëshme. Sepse Perëndia nukë dërgoj

të Birrë ndë botët, që të gjykonjë botënë, po  
18 që të shpëtonjë bota me anë t' ati. Ay që i  
beson ati, nukë gjykonetë; po ay që nukë  
beson, që ndashti ësthë dënuarë, sepse nukë  
besoj mb' emërit të të-vetëmlindurit Bir të  
19 Perëndisë. Edhe ky është gjyqi, se drita er-  
dhi ndë botët, edhe njerëzitë deshnë më te-  
përë errësirënë se dritënë; sepse punërat' e  
20 atyreve ishinë të-liga. Sepse kushdo që pu-  
non *punëra* të-këqia, i ka mëri dritësë, edhe  
nukë vjen te drita, që të mos sbulonenë  
21 punërat' e ati. Po ay që bën të-vërtetënë,  
vjen te drita, që të dëftenenë punërat' e ati,  
se janë punuarë mbë Perëndinë.

22 Pastaj erdhi Jisuj edhe nxënësit' e ti ndë  
dhet të Judhësë, edhe atje shkante kohënë  
23 bashkë me ata, edhe pagëzonte. Ishte edhe  
Joani dyke pagëzuarë nd' Enon, afërë Sali-  
mit, sepse atje ishinë shumë ujëra; edhe vi-  
24 ninë e pagëzoneshinë. Sepse Joani edhe s'  
25 ishte hedhurë ndë burkt. Ubë pra një të-kër-  
kuarë për *punë* pastrimi prej nxënëset të  
26 Joanit me *ca* Judhenj; Edhe erthnë te Joani  
edhe i than' ati' Ravvi, ay që ishte baskë  
me ty përtej Jordhanit, për të-cilinë ti dësh-  
move, ja ky tek po pagëzon, edhe të-gjithë  
vijnë tek ay.

27 Joani upërgjehq e tha, Njeriu nukë munt  
të marrë asgjë, nde mos i është dhënë nga  
28 qielli. Ju vetë dëshmoni për mua se thashë,

Unë nukë jam Krishti, po se jam dërguarë për-  
 29 para ati. Ay që ka nusenë, është dhëndërrri;  
 edhe miku i dhëndërrit, ay që rri e dëgjon atë;  
 qëzonetë me gëzim të-math për zërin' e  
 30 dhëndërrit. Ky pra gëzimi im umbush. Ay  
 31 duhetë të shtonetë, e unë të pakësonem. Ay  
 që vjen prej së-larti, është sipërë të-gjithave.  
 Ay që është prej dheut, prej dheut është,  
 edhe prej dheut flet; ay që vjen prej qiellit,  
 32 është sipërë të-gjithave. Edhe atë që pa edhe  
 dëgjoj, për këtë dëshmon; po asndonjë nuk'  
 33 e pret dëshmimn' e ati. Ay që pret dëshmimn'  
 e ati, ka vënë vulë se Perëndia është' i-  
 34 vërtetë. Sepse ay që ka dërguarë Perëndia;  
 fjalët' e Perëndisë flet; sepse Perëndia nuk'  
 35 e ep Frymën' e *ti* me masë. Ati do Birinë,  
 36 edhe të gjitha j'a ka dhënë ndë dorët. Ay që  
 i beson Birit ka jetë të-përjetëshme; po ay  
 që nukë bindetë te Biri, nukë dotë shohë je-  
 të, po zëmërat' e Perëndisë mbetetë mb' atë.

#### Krye 4.

1 Zoti pra si e mori vesh, se Farisenjtë dë-  
 gjuanë, se Jisuj bën e pagëzon më tepërë nxë-  
 2 nës se Joani, (Ndonëse Jisuj vetë nukë pagë-  
 3 zonte, po nxënësit' e ati;) La Judhenë, edhe  
 4 vate përsëri ndë Galilet. Edhe duhej të shkon-  
 te ndëpër Samarit.

5 Vjen pra ndë një qytet të Samarisë që thu-  
 hetë Sihar, afër' *ati* vëndit qe j'a dha Jakovi



- 6 Josifit birit të ti. Edhe atje ishte një pus i  
Jakovit. Jisuj pra pasi ishte lodhurë nga  
udha, kështu ndënjti përanë pusit; edhe ora  
7 ishte sindonja gjashtë. Vjen një grua nga  
Samaria të nxjerrë ujë. Jisuj i thot' asaj, Ep-  
8 më të pi. Sepse nxënësit' e ati kishinë va-  
9 turë ndë qytett, për të blerë të - ngrëna. I  
thotë pra ati gruaja Samarite, Qysh ti, dyke  
qënë Judhe, kërkon të pish prej meje, qe jam  
*një* grua Samarite? - Sepse Judhenjtë nukë  
shoqëronjënë me Samaritëtë.
- 10 Jisuj upërgjeq e i tha asaj, Po të dinje  
dhurëtin' e Perëndisë, edhe cili është' ay që  
të thotë, Ep-më të pi, ti kishnje për të ly-  
purë prej ati, edhe ay kishte për të dhënë  
11 ty ujë të-gjallë. Gruaja i thotë, Zot, as kovë  
ke, edhe pusi është' i-thellë, nga e ke ti pra  
12 ujët' e-gjalle? Mos je ti më i-math se ati y-  
në Jakov, i-cili na ka dhënë këtë pus, edhe  
vët' ay pinte nga ky, edhe të bijt' e ati, edhe  
13 bagëtit' e ati? Jisuj upërgjeq e i tha asaj,  
Kushdo qe pi nga këta ujë, dot' i vinjë et  
14 përsëri; Po ay që pi nga ujëtë qe dot' i ap  
unë, nukë dot' i vinjë et për *gjithë* jetënë;  
po ujëtë, që dot' i ap unë, dot' i bënetë bu-  
rim uji që buron për jetë të-përjetëshme.
- 15 Gruaja i thotë, Zot, ep-më këta ujë, që të  
mos më vinjë et, as të mos vinj' këtu të  
nxjer ujë.
- 16 Jisuj i thot asaj, Ecë, thirrë burrinë t'

17 ënt, edhe eja këtu. Gruaja upërgjeq e tha, S'  
18 kam burrë. Jisuj i tha asaj, Mirë the, se s'  
kam burrë; Sepse ke marrë pesë burra, edhe  
ay, që ke ndashti, nuk është burri yt; këtë  
e fole me të vërtetë.

19 Gruaja i thotë, Zot, po shoh, se ti je pro-  
20 tit. Atëritë t' anë ndë këtë mal ufalné; e ju  
thoni, se ndë Jerusalem është vëndi, ku du-  
21 hetë të falemi. Jisuj i thot' asaj, Grua, besomë,  
se vjen një orë, kur nukë dot' i faleni  
22 Atit as ndë këtë mal, as ndë Jerusalem. Ju  
i faleni ati që nukë dini; neve i falemi ati që  
dimë; sepse shpëtimi është nga Judhenjtë.  
23 Po vjen një orë, edhe ndashti është, kur fa-  
lëtorët' e-vërtetë dot' i falenë Atit me frymë  
e me të-vërtetë; sepse edhe Ati të-këtitillë  
24 kërkon të jenë ata që i falenë ati. Perëndia  
është frymë, edhe ata që i falenë duhetë të  
falenë me frymë e me të-vërtetë.

25 Gruaja i thotë, E di se vjen Messia, ay  
që thuhetë Krisht; ay kur të vinjë, dotë na  
26 apë zë për të-gjitha. Jisuj i thot' asaj, Unë  
që të flas jam ay.

27 Edhe mbi këto *fjalë* erthnë nxënësit' e  
ati, edhe uçuditnë se fliste me grua; po as ndo-  
një s' tha, Ç' kërkon? a, Ç flet me atë?

28 Gruaja pra la shtëmbën' e saj, edhe vate  
29 ndë qytett, edhe u thotë njerëzet, Ejani e  
shihni një njeri, që më tha gjithë sa kam

30 bërë; vallë mos është ky Krishti? Duallnë  
pra nga qyteti, edhe erthnë tek ay.

31 Edhe ndër mest të këtyre fjalëve nxënë-  
32 sit' i luteshinë, dyke, thënë, Ravvi ha. Po ay  
u tha atyre, Unë kam të ha një të-ngrënë,  
33 që ju nuk' e dimi. Nxënësitë pra i thoshinë  
njëri tjetrit, Mos i pru njeri të hajë?

34 Jisuj u thot' atyre, Të-ngrënë të t' im është  
të bënj dashurimn' e ati që më ka dërguarë,  
35 edhe të mbaronj punën' e ati. Nukë thoni  
ju, Se jan' edhe katrë muaj, edhe vjen të-  
korrëtë? Na tek po u them juve, Ngrini për-  
pjetë sytë t' uaj, edhe shihni aratë, se janë  
36 tashi të-bardha për të korrë. Edhe ay që  
korr merr pagë, edhe mbleth pemë për jetë  
të përjetëshme, që të gëzonetë bashkë edhe  
37 ay që mbjell edhe ay që korr. Sepse mbë  
këtë e-vërtetë është fjala, Se tjetër' është ay  
38 që mbjell, edhe tjetër' ay që korr. Unë u  
dërgova juve të kornni atë, për të-cilënë juve  
s' jeni munduarë; të-tjerë umunduanë, edhe  
ju hytë ndë mundimt t' atyreve.

39 Edhe prej ati gyteti shumë nga Samari-  
tëtë besuanë për fjalën' e gruasë që dëshmoj,  
40 Se më tha gjithë sa kam bërë. Samaritëtë  
pra si erthnë tek ay, i luteshinë të mbesë  
41 për an' atyreve. Edhe mbeti atje dy dit. Edhe  
shumë më tepërë njerës besuanë për fjalën'  
42 e ati; Edhe gruasë i thoshinë, Se nukë be-  
sojmë më për fjalënë t' ende; sepse neve e

dëgjuamë, edhe e njohmë se ky është me të-vërtetë Shpëtimtari i botësë, Krishti.

43 Edhe pas dy ditsh dolli prej andej, edhe  
44 vate ndë Galilet. Sepse vetë Jisuj dëshmoj, se  
*asndonjë* profit s' ka nder ndë dhet të ti.  
45 Kur erdhi pra ndë Galilet, Galileasit' e pritnë,  
passi kishinë parë gjithë sa bëri ndë Jeru-  
salim ndë të-kremtet; sepse edhe ata kishinë  
46 ardhurë për të-kremtenë. Jisuj pra erdhi përsëri  
ndë Kana të Galilesë, ku kishte bërë ujëtë  
verë.

Edhe ishte një njeri mbretërie, djal' i të-  
47 cilit ishte i-sëmurë ndë Kapernaum. Ky  
kur dëgjoj, se Jisuj erdhi nga Judhea ndë  
Galilet, vate tek ay, edhe i lutej të sbresë e  
të shëronjë të birr' e ati; Sepse ishte për të  
48 vdekurë. Jisuj pra i tha. Ndë mos pafshi shë-  
49 nja e çudira, s' kini për të besuarë. Njeriu  
i mbretërisë i thotë, Zot, sbrit para se të vdesë  
50 çuni im. Jisuj i thotë, Ecë, se yt bir rron.  
Edhe njeriu i besoj fjalësë që i tha Jisuj, edhe  
51 iku. Edhe tek po sbriste, shërbërorët' e ati  
upoqnë me atë, edhe i dhanë zë, Se yt bir  
52 rron. I pyeti pra mbë ç' orë ubë më mirë.  
Edhe i thanë, Se dje mbë të-shtattënë orë e  
53 lanë ethetë. I ati pra e kupëtoj se *këjo ubë*  
mb' atë orë që i tha Jisuj, Se yt bir rron;  
edhe besoj ay edhe gjithë shtëpi' e ati.

54 Jisuj bëri përsëri këtë çudi të-dytë, si er-  
dhi nga Judhea ndë Jerusalem.

## Krye 5.

1 Pas këtyreve ishte *një* e-kremte e Judhe-  
 2 njet; edhe Jisuj hipi ndë Jerusalim. Edhe ndë  
 Jerusalim afërë *derës'* së dhënet është një  
 pellk *uji* që quhetë Ebraisht Vithesdha, edhe  
 3 ka pesë kamare. Ndër këto dirgjej shumë  
 shumicë të-sëmurësh, të-verbërësh, të-çalësh  
 4 të-thatësh, që pritinë të-luajturit' e ujit. Sepse  
 kohë mbë kohë sbriste një ëngjëll ndë pellkt,  
 edhe trazonte ujëtë; cili pra të hynte më për-  
 para, pas të-trazuarit t' ujit, bënej i-shëndoshë  
 prej çdo farë smundjeje që të kishte.

5 Edhe atje ishte një njeri, që ishte i-  
 6 sëmurë tri-dhjet' e tetë vjet. Jisuj kur e pa  
 këtë së po dirgjej, edhe mori vesh se prej  
 shumë kohe ndashti ishte *i-sëmurë*, i thotë,  
 7 A do të bënesh i-shëndoshë? I sëmuri i upër-  
 gjeq, Zot, s' kam njeri të më vërë ndë pellkt,  
 kur trazonet' ujëtë; sepse tek po vinj unë,  
 8 tjetërë sbret përpara meje. Jisuj i thotë, Çohu,  
 9 ngri shtratinë t' ënt, edhe ecë. Edhe për-një-  
 here njeriu ubë i-shëndoshë, edhe ngriti  
 shtratin' e ti, edhe ecënte. Edhe atë ditë ishte  
 e-shëtunë.

10 Judhenjtë pra i thoshin' ati që ushërua  
 Esht' e-shëtunë; nuk është' e udhësë të ngresh  
 11 shtratinë. Ay u upërgjeq atyre, Ay<sup>!</sup> që më shëroj  
 12 me tha, Ngri shtratinë t' ënt, edhe ecë. E  
 pyetnë pra, Cili ështëë ay njeri që të tha,

- 13 Ngri shtratinë t' ënt' edhe ecë? Po ay që  
ushërua nukë dinte cili është; Sepse Jisuj  
ushtëmenk, sepse kishte shumë gjindje nd'  
atë vënt.
- 14 Pastaj Jisuj e gjen atë ndë hieroret, edhe i  
tha, Na tek ubëre i-shëndoshë; mos bëj më  
faj, që të mos të bënetë ndonjë gjë m' e-  
15 keqe. Njeriu pra shkoj, edhe u dha zë Judhe-  
njet, se ay që e bëri të-shëndoshë është Jisuj.
- 16 Edhe përandaj Judhenjtë e ndiqninë Jisunë,  
dhe kërkoninë t'a vritninë, sepse bënte këto  
17 ditën e-shëtunë. Po Jisuj u upërgjeq atyre, Im  
Atë punon gjer ndashti, edhe unë punonj.
- 18 Përandaj Judhenjtë më tepërë kërkoninë t'a  
vritninë, sepse jo vetëmë e prishte të-shëtu-  
nënë, po edhe se thoshte, se Perëndia është  
i ati, duke bërë vetëhen' e ti si-një-një me  
Perëndinë.
- 19 Jisuj pra upërgjeq e u tha atyre,  
Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them  
juve, Biri s' munt të bënjë asgjë prej vetin,  
ndë mos pafte Atinë dyke bërë këtë; sepse  
ato që bën ay, këto i bën gjithashtu edhe  
20 Biri. Sepse Ati e do Birinë, edhe i dëften  
gjith' ato që bën vetë; edhe dot' i dëftenjë  
punëra më të-mëdha se këto, që të çuditeni  
21 ju. Sepse sikundrë Ati ngjall të-vdekuritë edhe  
ep jetë, kështu edhe Biri u ep jetë atyreve  
22 që të dojë. Sepse Ati nukë gjykon asdonjë,  
po gjithë gjyqinë j'a dha Birit, [që të-gjithë.

të nderonjënë Birinë, sikundrë nderonjën' Atinë. Ay që nukë nderon Birinë, nukë nderon Atinë që e ka dërguarë.

- 24 Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve, se ay që dëgjon fjalënë t' ime, edhe i beson ati që më ka dërguarë, ka jetë të-përjetëshme, edhe ndë gjyq nukë vjen, po
- 25 shkoj prej vdekjesë ndë jetët. Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve, se vjen një orë, edhe ndashti është, kur të-vdekuritë kanë për të dëgjuarë zërin' e të Birit të Perëndisë, edhe ata që dëgjonjënë dotë rronjënë.
- 26 Sepse sikundrë Ati ka jetë ndë vetëhet të ti, kështu i dha edhe të Birit të ketë jetë ndë
- 27 vetëhet të ti; Edhe i dha pushtet të bënëj
- 28 edhe gjyq, sepse është Bir njeriu. Mos uçuditni për këtë; se vjen një orë, ndë të-cilët gjith' ata që janë ndëpër varret dotë dëgjo-
- 29 njënë zërin' e ati; Edhe dotë dalënë ata që kanë bërë të-mira ndë të-ngjallurë jetë; po ata që kanë punuarë të-liga, ndë të-ngjallurë gjyqi.
- 30 Unë s' munt të bënëj asgjë prej vetëhesë s' ime. Sikundrë dëgjonj, gjukonj; edhe gjyqi im është i-drejtë; sepse s' kërkonj dashurimnë t' im, po dashurimn' e (Atit) që më dërgoj.
- 31 Unë ndë dëshmofsha për vetëhenë t' ime,
- 32 dëshmimi im nuk' është i-vërtetë. Tjetërë është ay që dëshmon për mua; edhe e di, se dësh-
- 33 mimi që dëshmon për mua është i-vërtetë. Ju

- dërguatë te Joani, edhe ay dëshmoj të-vër-  
34 tetënë. Edhe unë nuk' e marr dëshmimnë  
prej njeriu; po them këto, që të shpëtoni ju.  
35 Ay ishte kandili që digjetë e bën dritë; edhe  
ju deshtë të gëzoheni për pak kohë ndë dritët  
t' ati.
- 36 Po unë e kam dëshmimnë më të-math se  
të Joanit; sepse ato punëra që më dha Ati  
që t' i mbaronj, ato punëratë që bënj unë,  
dëshmonjënë për mua, se Ati më ka dër-  
37 guarë. Edhe Ati që më dërgoj, ay dëshmon  
për mua. As zërin' e ati s' e keni dëgjuarë  
38 kurrë, as faqen' e ati s' e keni parë. Edhe  
fjal' e ati s' ka të-ndënjurë ndër ju, sepse  
39 ju nuk' i besoni këti që dërgoj ay. Vëzhgoni  
shkronjatë, sepse ju kujtoni se ndër ato keni  
jetë të-përjetëshme; edhe ato jan' ato që  
40 dëshmonjënë për mua. Po s' doni të vini  
41 tek unë, që të keni jetë. Nukë marr lavdi  
42 prej njerëzish; Po u njoha juve, se s' keni  
dashurin' e Perëndisë ndër vetëhet t' uaj.  
43 Unë kam ardhurë mb' emërit të t' im Eti, e  
nukë më prisni; nd' arthtë *ndonjë* tjetërë mb'  
44 emërit të ti, dot' e prisni atë. Qysh muntni  
të besoni ju që merrni lavdi njeri prej tje-  
tërit, edhe nukë kërkoni lavdinë që është  
prej të-vetëmit Perëndi?
- 45 Mos kujtoni, se unë dot' u përflas juve  
tek Ati; ka kush t' u përflasë juve, Moisiu,  
46 mbë të-cilinë ju shpryetë. Sepse po t' i kishi-



të besuarë Moisiut, dotë më besonit' edhe  
47 mua; sepse ay shkroj për mua. Po ndë  
qoftë se nuk' u besoni të-shkruaravet t' ati,  
qysh dot' u besoni fjalëvet të mia?

### Krye 6

- 1 Pastaj Jisuj shkoj përtej detit të Galilesë,  
2 të Tiveriadhësë: Edhe shumë gjindje i vanë  
pas, sepse shihninë çudirat' e ati që bënte mbi  
3 të-sëmurët. Edhe Jisuj hipi ndë malt, edhe  
rrinte atje bashkë me nxënësit' e ti.
- 4 Edhe ishte afërë pashka, e-kremteja e  
Judhenjet.
- 5 Jisuj pra kur ngriti sytë, edhe pa se po  
vinte shumë gjindje tek ay, i thotë Filipit,  
6 Nga dotë blemë bukë, që të hanë këta? (Edhe  
thoshte këtë, që t'a provonte; sepse ay e  
7 dinte seç dotë bënte.) Filipi i upërgjeq, Dy  
qint dinarë bukë nuk' u dalën' atyre, që të  
marrë nga një çikë gjithë-si-cili nga ata.
- 8 Andreu i vëllaj i Simon Pjetrit, një nga  
9 nxënësit' e ati, i thotë, Këtu është një çun  
i-vogëlë që ka pesë bukë të-elpta, edhe dy  
pishqe; Po ç' janë këto për kaqë *veta*?
- 10 Edhe Jisuj tha, Thoj-u-ni njerëzet të rrinë  
përdhe. Edhe ishte shumë bar nd' atë vënt.  
Ndënjnë pra burratë sindonja pesë mijë *veta*  
11 me numërë. Edhe Jisuj mori bukëtë, edhe si  
ufal ndersë, u'a ndau nxënëset, edhe nxënësitë  
atyre që kishinë ndënjurë përdhe; kështu

- 12 edhe prej pishqevet sa deshnë. Edhe si un-  
ginjë, u thotë nxënëset të ti, Mblithni  
copatë që kanë tepëruarë, që të mos hum-  
13 òasë gjë. I mblotnë pra, edhe mbushnë  
dy-mbë-dhjetë kofinë me copa nga të pesë  
bukët' e-elpta që u tepëruanë atyreve që  
hëngrë.
- 14 Njerëzitë pra, kur panë çudinë që bëri  
Jisuj, thoshinë, Se me të-vërtetë ky është ay  
profiti që ka për të ardhurë ndë botët.  
15 Jisuj pra si e kupëtoj, se doninë të vininë,  
e t'a rrëmbeninë, që t'a bëninë mbret, iku  
përsëri ndë malt ay vetëmë.
- 16 Edhe si ungrys, nxënësit' e ati sbritnë  
17 ndë dett; Edhe hynë ndë lundrët, edhe shkua-  
anë përtej detit ndë Kapernaum. Edhe ndash-  
ti ishte bërë errëte, edhe Jisuj s' kishte ar-  
18 dhurë tek ata; Edhe deti po ngrihej, se po  
19 frynte er' e-madhe. Passi vozitnë pra sindo-  
nja një-zet e pesë a tridhjetë stadhe, shohënë  
Jisunë dyke ecurë mbi dett, edhe dyke ardhurë  
20 afërë lundrësë; edhe ufrikësuanë. Po ay u  
21 thot' atyre, Unë jam, mos ufrikësoni. Deshnë  
pra t'a marrënë ndë lundrët; edhe për-një-  
here lundra ugjënt mb' atë dhe që vininë.
- 22 Mbë të-nesërmet gjindja që kishte ndënjurë  
përtej detit, kur panë, se s' ishte atje  
tjetërë lundrëzë, veç një, ajo, ndë të-cilët  
hynë nxënësit' e ti, edhe se nukë hyri Jisuj  
ndë lundrëzët bashkë me nxënësit' e ti, po

- 23 vetëmë nxënësit' e ati, shkuanë; (Edhe të-  
tjera lundrëza erthnë nga Tiveriadha afër'  
ati vëndi ku hëngrrë bukënë, passi ufal  
24 ndersë Zoti;) Gjindja pra kur pa, se Jisuj  
nuk është atje, as nxënësit' e ati, hipnë edhe  
ata ndëpër lundrat, edhe erthnë ndë Kaper-  
naum dyke kërkuarë Jisunë.
- 25 Edhe si e gjetnë përtej detit, i thanë,  
26 Ravvi, kur erdhe këtu? Jisuj u upërgjeq a-  
tyre e tha, Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u  
them juve, më kërkon, jo sepse patë çudira,  
po sepse hengrëtë nga bukëtë edhe unginjtë.
- 27 Mos punoni për ushqiminë që prishetë, po  
për ushqiminë që mbëtetë për jetë të përje-  
tëshme, të-cilinë dot' u apë juve i Bir' i nje-  
riut; sepse këtë e vulosi Ati, Perëndia.
- 28 I thanë pra, Ç' të bëjmë, që të punojmë  
29 punërat' e Perëndisë? Jisuj upërgjeq e u tha  
atyre, Kejo është pun' e Perëndisë, t' i be-  
soni ati që ka dërguar' ay.
- 30 I thanë pra, Ç' shënjë bën pra ti, që të  
31 shohëmë, e të të besojmë ty? ç punon? Atë-  
ritë t' anë hëngrrë mannënë ndë shkretëtirët,  
sikundrë është shkruarë, " Bukë nga qielli  
32 u dha atyre të hanë., Jisuj pra u tha atyre,  
Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve,  
Moisiu nuk' u dha juve bukënë nga qielli;  
po im Atë u ep juve bukën' e-vërtetë nga  
33 qielli. Sepse buk' e Perëndisë është ay që  
sbret nga qielli, edhe qe i ep jetë botësë.

- 34 I thanë pra, Zot, ep-na përherë këtë bukë.  
35 Edhe Jisuj u tha atyre, Unë jam buk' e  
jetësë; ay që vjen tek unë, nukë dotë këtë  
uri; edhe ay që më beson, nukë dotë këtë  
36 et kurrë. Po u thashë juve, se edhe më patë  
37 edhe nukë besoni. Gjithë ç' më ep Ati, dotë  
vinjë tek unë; edhe atë që të vinjë tek unë,  
38 nukë dot' e nxjer jashtë; Sepse kam sbri-  
turë nga qielli, jo për të bërë dashuriminë  
t' im, po dashurimin' e ati që më ka dërgu-  
39 arë. Edhe ky është dashurimi i Atit që më  
ka dërguarë, prej gjithë ç' më ka dhënë të  
mos humbas asgjë, po t'a ngjall ndë ditët  
40 të-pastajme. Edhe ky është dashurimi i ati  
që më ka dërguarë, kushdo që sheh Birinë  
e i beson, të këtë jetë të-përjetëshme; edhe  
unë dot'a ngjall ndë ditët të-pastajme.
- 41 Judhenjtë pra murmurisninë për atë, se  
42 tha, Unë jam buka që sbrita nga qielli; Edhe  
thoshinë, Nuk' është ky Jisuj i bir' i Josifit,  
të-cilit neve i njohëmë t' an' edhe t' ëmënë;  
qysh thotë pra ky, Se kam sbriturë nga  
qielli?
- 43 Jisuj pra upërgjeq e u tha atyre, Mos  
44 murmurisni ndë mest t' uaj. Asndonjë s' munt  
të vinjë tek unë, ndë mos e heqtë Ati që  
më ka dërguarë; edhe unë dot'a ngjall atë ndë  
45 ditët të-past'ajme. Është shkruarë ndë pro-  
fitërit, "Edhe të-gjithë dotë jenë të-mësuarë  
nga Perëndia.,, Kushdo pra që ka dëgjuarë

prej Atit, edhe është mësuarë, vjen tek uuë.  
46 Jo se ka parë ndonjë Atinë, veç ay që është  
nga Perendia; ky e ka parë Atinë. Me të-  
47 vërtetë po u them juve, Ay që më beson ka  
48 jetë të-përjetëshme. Unë jam buk' e jetësë.  
49 Atëritë t' uaj hëngrë mannënë ndë shkretë-  
50 tirët, edhe vdiqnë. Kejo është buka që sbret  
nga qielli, që të haje ndonjë prej asaj, edhe  
51 te mos vdesë. Unë jam buk' e-gjallë që sbriti  
nga qielli. Nde hëngretë njeri prej kësaj buke,  
dotë rronjë për gjithë jetënë. Edhe buka qe  
dot' ap unë, është mishi im, të-cilinë unë  
dot'a ap për jetën' e botësë.

52 Judhenjtë pra haheshinë njëri me tjatinë,  
dyke thënë, Qysh munt të na apë ky të hamë  
mishin' e ati?

53 Jisuj pra u tha atyre,, Me të-vërtetë, me  
të-vërtetë po u them juve, Ndë mos hëngrëshi  
mishin' e të Birit të njeriut, edhe ndë mos  
pifshi gjakun' e ati, s' keni jetë ndë vetëhet  
54 t' uaj. Ay që ha mishinë t' im, edhe pi gja-  
kunë t' im, ka jetë të-përjetëshme, edhe unë  
55 dot'a ngjall ndë ditët të-pastajme. Sepse mi-  
shi im është me të-vërtetë ushqim, edhe  
56 gjaku im është me të-vërtetë të-pirë. Ay që  
ha mishinë t' im, edhe pi gjakunë t' im, mbe-  
57 tetë tek unë, edhe unë tek ay. Sikundrë më  
dërgoj Ati që rron, edhe unë rronj për Atinë,  
*kështu* edhe ay që ha mua, dotë rronjë edhe  
58 ay për mua. Këjo është buka që sbriti nga

qielli; jo sikundrë atëritë t' anë hëngrrë man-  
nënë, edhe vdiqnë; ay që ha këtë bukë,  
dotë rronjë për gjithë jetënë.

59 Këto tha ndë sinagogjit dyke mësuarë  
ndë Kapernaum.

60 Shumë *veta* pra nga nxënësit' e ati kur  
dëgjuanë, thanë, Këjo fjalë është' e-ashpërë;

61 cili munt t'a dëgjonjë? Edhe Jisuj si e ku-  
pëtoj ndë vetëhet, se nxënësit' e ti po mur-  
murisinë për këtë *fjalë*, u tha atyre, Këjo

62 uskandhalis juve? *Ç' dotë thoni* pra, ndë  
qoftë se shihni të Birin' e njeriut dyke hi-

63 purë atje ku ishte më përpara? Fryma është'  
ajo që ep jetë; mishi nukë vëjen asgjë; fja-

64 lëtë qe u flas unë juve, janë frymë, edhe janë  
jetë. Po janë ca prej jush që nukë beso-

njënë. Sepse Jisuj e dinte që ndë kryet, cilëtë  
jan' ata që s' besonjënë, edhe cili është' ay

65 që dot'a trathëtonte. Edhe thoshte, Përandaj  
u thashë juve, se asndonje s' munt të vinjë

tek unë, ndë mos i është dhënë prej t' im  
Eti.

65 Që mb' atë herë pra shumë nga nxë-  
nësit' e ti ukthyenë prapa, edhe nuk' ecninë  
më bashkë me atë.

67 Jisuj pra u tha të dy-mbë-dhjetëvet, Mos  
68 doni të ikëni edhe ju? Simon Pietri i upër-  
gjeq pra ati, Zot, Te cili të vemi? *tike* fjalë jete

69 së-përjetëshme. Edhe neve kemi besuarë,  
edhe e kemi njohurë, se ti je Krishti i Bir' i

- 70 Perëndisë (së-gjalë). Jisuj u upërgjeq atyre, A nuk' u sgjodha unë juve të dy-mbë-dhjetëtë?  
 71 Po një prej jush është djall. Edhe thoshte për Judhë Jskariotinë, *të birin'* e Simonit; sepse ky, ndonëse ishte një prej të dy-mbë-dhjetëvet, e kishte për të trathëtuar' atë.

### Krye 7.

- 1 Edhe pas këtyre *fjalëve* Jisuj ecënte ndë Galilet; sepse s' donte të ecënte ndë Judhet, sepse Judhenjtë kërkoninë t'a vrisninë.  
 2 Edhe ishte afër' e-kremteja e Judhenjet,  
 3 tendë-ngrehëja. Të vëllezërit' e ti pra i thanë, Ikë së-këtejmi, edhe ecë ndë Judhet, që të shohën' edhe nxënësit' e tu punërat' e tua që  
 4 bën; Sepse asndonjë s' bën gjë fshehurazi, edhe kërkon vetë të jet' i-çfaqurë. Ndë bën  
 5 këto, çfaq vetëhenë t' ende ndë botët. Sepse  
 6 as të vëllezërit' e ti nuk' i besoninë. Jisuj u thotë pra atyre, Koha ime edhe s' ka ardhurë,  
 7 po koha juaj është përherë gati. Bota s' munt t' u ketë mëri juve; po mua më ka mëri, sepse unë dëshmonj për atë, se punë-  
 8 rat' e asaj janë të-liga. Ju hipni ndë këtë të-kremtë; unë (edhe) nukë vete nde këtë të-kremte, sepse koha ime edhe s' është mbushurë.  
 9 Edhe si u tha atyre këto, mbeti ndë Ga-  
 10 lilet. Edhe si hipnë të vëllezërit' e ati, hipi

edhe ay ndë të-kremtet, jo faqeza, po si fshehurazi.

- 11 Judhenjtë pra e kërkoninë ndë të-kremtet,  
12 edhe thoshinë, Ku është' ay? Edhe ishte për  
atë shumë murmuri ndër mest të gjindjesë;  
Ca thoshinë, Se është' i -mirë; e të-tjerë tho-  
13 shinë, Jo; po gënjen gjindjenë. Po asndonjë  
nukë fliste sheshit për atë, nga frika e Judhe-  
njet.
- 14 Edhe ndashti tek ishte përgjurmë e-krem-  
15 tja, Jisuj hipi ndë hieroret, edhe mësonte.  
Edhe Judhenjtë çuditeshinë, dyke thënë, Qysh  
di ky dituri pa mësuarë?
- 16 Jisuj u upërgjeq atyre, e tha, 'Mësimi im  
nuk' është imi, po i ati që më ka dërguarë.  
17 Ndë do ndonjë të bënë dashurimn' e ati,  
dotë njohë për mësimnë, nd' është nga Pe-  
rëndia, apo ndë flas unë prej vetëhesë s' ime.  
18 Ay që flet prej vetëhes' së ti, kërkon lavdin'  
e ti; po ay që kërkon lavdin' e ati që e ka  
dërguarë, ky është i-vërtetë, edhe shtrëmbëri  
19 tek ay nukë ka. A nuk' u dha juve nominë  
Moisiu? edhe asnjë prej jush s' bën nominë  
Përse kërkonit të më vrisni?
- 20 Gjindja upërgjeq e tha, ke djallinë. Cili  
kërkon të të vrasë?
- 21 Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Një punë  
22 bëra, edhe të-gjithë çuditëni. Përandaj Moi-  
siu u ka dhënë juve rrethpresjenë, (jo se  
është nga Moisiu, po nga atëritë,) edhe të-



- 23 shëtunë rrethprisni njeri. Ndë qoftë se njeriu merr rrethpresje *ditën'* e-shëtunë, që të mos prishetë nom' i Moisiut, mbë mua zëmëroneni, sepse një njeri të-tërë e bëra të-shëndoshë *ditën'* e-shëtunë? Mos gjykoni për faqe, po gjykoni gjyqin' e-drejtë.
- 25 Ca pra prej Jerosolimitëvet thoshinë, Nuk' është ky që kërkoninë t'a vrasënë? Po na tek po flet ndër sy, edhe s' i thonë asgjë. Mos e njohinë me të-vërtetë të-parëtë, se ky është me të-vërtetë Krishti? Po këtë e dimë nga është; po kur vjen Krishti, asdonjë s' e di nga është.
- 28 Jisuj pra thërriti dyke mësuarë ndë hieroret, edhe tha, Edhe mua më dini, edhe nga jam e dini; edhe s' kam ardhurë prej vetin, po është i vërtetë ay që më ka dërguarë, të-cilinë ju nuk'e dini; Po un'e di atë, sepse jam prej ati, edhe ay më dërgoj.
- 29 Kërkoninë pra t'a zënë; po asndonjë s' vuri dorënë mbi atë, sepse edhe s' i kishte ardhurë ora.
- 31 Edhe shumë *veta* prej gjindjesë i besuanë, edhe thoshinë, Se kur të vinjë Krishti, mos dotë bënje më shumë shënja se këto që bëri ky?
- 32 Farisenjtë dëgjuanë gjindjenë se po pishpëllinjënë këto për atë; edhe dërguanë Farisenjt' edhe kryepritëritë-shërbëtorë që t'a zënë.
- 33 Jisuj pra u tha (atyre), Edhe pak kohë jam

- bashkë me ju, edhe vete tek ay që më dër-  
34 goj. Dotë më kërkoni, e nukë dotë më gjeni;  
Edhe *atje* ku jam unë ju s' munt të vini.
- 35 Judhenjtë pra thanë me vetëhen' e tyre, Ku  
dotë vejë ky, që neve nukë dot'a gjejmë? Mos  
dotë vejë ndër ata që janë përndarë ndër  
36 Grekërit, e të mësonje Grekëritë? Ç' është  
këjo fjalë qe tha, Dotë më kërkoni, e nukë  
dotë më gjeni? edhe, *Atje* ku jam unë, ju s'  
munt të vini?
- 37 Edhe të-pastajmenë ditë, *ditën'* e-madhe  
e së-kremtesë, Jisuj qëndroj e thërriti, dyke  
thënë, Kush të ketë et, letë vinjë tek unë, e  
38 letë pijë. Ay që më beson mua, sikundrë tha  
Shkronja, lumënj uji të-gjallë dotë rrjedhënë  
39 nga barku i ati. (Edhe këtë e tha për Fry-  
mënë që kishinë për të marrë ata që dot' i  
besoninë; sepse edhe s' ishte *dhënë* Frym' e-  
Shënjtëruarë; sepse Jisuj edhe s' ishte lav-  
duruarë.)
- 40 Shumë *veta* pra prej gjindjesë kur dëgiu-  
anë këtë fjalë, thoshinë, Ky është me të-  
41 vërtetë profiti. Të-tjerë thoshinë, Ky është  
Krishti. Po të-tjerë thoshinë, Mos vjen Krish-  
42 ti nga Galilea? Nuke tha shkronja, se Kri-  
shti vjen nga far' e Dhavidhit, edhe nga  
43 fshati Vithleem, që ku ishte Davidhi? Ubë  
44 pra një çarje ndër gjendjet për atë. Edhe ca  
prej atyreve doninë t'a zininë; po asndonjë  
s' vuri duartë mbi atë.

45 Erthnë pra shërbëtorëtë te kryepriftërit' e  
 46 te Farisenjtë, edhe ata u than' atyre, Përse  
 s' e prutë? Shërbëtorëtë upërgjeqnë, Askurre  
*ndonjëherë* s' ka folurë njeri kështu, posi ky  
 47 njeri. Farisenjtë pra u upërgjeqnë atyre, Mos  
 48 ugënjyet' edhe ju? Mos i ka besuarë at<sup>i</sup>  
 49 ndonjë prej të-parëvet a prej Farisenjvet? Po  
 këjo gjindje që s' di nomnë, janë të mallë-  
 kuarë.

50 U thot' atyre Nikodhimi, (ay që pat ar-  
 dhurë natënë tek ay, i-cili ishte një prej a-  
 51 tyre,) Mos e gjykon njerinë nomi ynë, pa  
 dëgjuarë më përpara prej ati, e pa marrë  
 52 vesh seç ben. Upërgjeqnë e i thanë, Mos je  
 edhe ti nga Galilea? vëzhgo e shih, se pro-  
 fit nga Galilea nuk' është ngriturë.

53 Edhe gjithë-sicili vate ndë shtëpit të ti.

### Krye 8

1 Edhe Jisuj vate nde malt t' ullinjet.

2 Edhe mbë të-vagulluarët erdhi përsëri  
 ndë hieroret, edhe gjithë llauzi vinte tnk ay;  
 edhe ay ndënji e i mësonte.

3 Edhe shkronjësit' e Farisenjtë i bjenë një  
 grua të-zënë ndë kurvëri, edhe si e vunë ndë  
 4 mest, I thonë, Mësonjës, këjo grua është zënë  
 5 mbi punët dyke kurvëruarë. Edhe Moisiu  
 ndë nomt na ka porositurë të-tillatë *gra* të  
 6 vritenë më gurë; ti pra ç' thua? Edhe këtë  
 e tdoshinë dyke ngarë atë, që të kenë me se

- t'a përflasënë. Po Jisuj uunjt, e skruante me  
7 gishinë mbë dhet. Edhe passi qëndroninë  
dyke pyetur' atë, ungrit, e u tha atyre, I-  
pafajmi prej jush, *ky* më përpara letë hedhë  
8 gurinë mbi atë. Edhe përsëri uunjt, e shkru-  
9 ante mbë dhet. Edhe ata kur dëgjuanë, edhe  
pasi qërtonëshinë prej ndërgjegjesë, zunë të  
dilninë jashtë një nga një, që prej pleqvet e  
gjer mbë të-fundëshmit; edhe Jisuj mbeti  
vetëmë, edh gruaja ishte dyke ndënjurë ndë  
10 mest. Edhe Jisuj si ungrit, edhe nukë pa  
asdonjë veç gruasë, i tha asaj, *Crua*, ku jan'  
ata që të përflisninë? asndonjë s' të dënoj?  
11 Edhe ajo tha, *Asndonjë*, *Zot*. Edhe Jisuj i tha,  
*As unë nukë të dënonj; shko*, edhe mos  
fëje më.
- 12 Jisuj pra përsëri u foli atyre, dyke thënë, *Unë  
jam drit' e botësë; ay që më vjen pas, nukë  
dot' ecënjë nd' errësirët, po dotë ketë dritën'  
e jetësë.*
- 13 *Farisenjtë* pra i thanë, *Ti dëshmon për  
vetëhenë t' ende; dëshmimi yt nuk' është i-  
14 vërtetë. Jisuj upërqjeq e u tha atyre, Edhe  
ndë dëshmofsha unë për vetëhenë t' ime,  
dëshmimi im është i-vërtetë, sepse e di nga  
erdha, e ku vete; po ju s' e dini nga erdha,  
15 e ku vete. Ju gjykoni pas mishit; unë nukë  
16 gjykpnj asnjeri. Po edhe ndë gjukofsha unë,  
gjyqi im është i-vërtetë; sepse nukë jam ve-  
17 tëmë, po unë edhe *Ati* që më dërgoj. Edhe ndë*

nomt t' uaj është shkruarë, Se dëshmimi i  
18 dy njerësve është i-vërtetë. Unë jam ay që  
dëshmonj për vetëhenë t'ime, edhe Ati që  
19 më dërgoj dëshmon për mua. I thoshinë pra,  
Ku është yt Atë? Jisuj upërçjeq. As mua s'më  
dini, as t' im Atë; po të më dinitë mua, dotë  
dinit' edhe t' im Atë.

20 Këto fjalë i foli Jisuj ndë vëntt të the-  
sarit, dyke mësuarë ndë hieroret; edhe as-  
ndonjë nuk' e zuri, sepse edhe s' i kishte  
ardhur' ora.

21 Jisuj pra përsëri u tha atyre, Unë po vete,  
edhe dotë më kërkoni, edhe dotë vdisni ndë  
fajt t' uaj. Ku vete unë, ju nukë munt të vi-  
22 ni. Judhenjtë pra thoshinë, Mos dotë vrasë  
vetëhen' e ti, e përandaj thotë, *Atje* ku vete  
23 unë, ju s' munt të vini? Edhe ay u tha a-  
tyre, Ju jeni prej atyre që janë poshtë, unë  
jam prej atyre që janë lart. Ju jeni prej kë-  
24 saj bote; unë nukë jam prej kësaj bote. U  
thashë pra juve, se dotë vdisni ndë fajet t' uaj;  
sepse ndë moq besofshi se unë jam, dotë  
vdisni ndë fajet t' uaj.

25 I thoshinë pra, Cili je ti? Edhe Jisuj u  
tha atyre, *Unë jam ay* që u thashë juve që  
26 ndë kryet. Shumë kam për të thënë, e për  
të gjykuarë për ju; po ay që më dërgoj është'  
i-vërtetë; edhe unë sa dëgjova prej ati, këto  
27 i them botësë.—Nukë kupëtuanë, se u thoshte  
për Atinë.

- 28 Jisuj pra u tha atyre, Kur të ngrini lart të Birin' e njeriut, atëhere dotë njihni se unë jam, edhe nukë bënj asgjë prej vetëhesë s' ime, po sikundrë më mësoj im Atë, këto flas.
- 29 Edhe ay që më dërgoj është bashkë me mua; Ati nukë më la vetëmë; sepse unë bënj përherë ato që i pëlqenjënë.
- 30 Ay tek ishte dyke folurë këto, shumë *veta* i besuanë.
- 31 Jisuj pra u thoshte atyre Judhenjet që i kishinë besuarë, Ndë qoftë se besoni ju ndë fjalët t' ime, jeni me të-vërtetë nxënës
- 32 të-mi; Edhe dotë njihni të-vërtetënë, edhe e-vërteta dot' u lironjë juve.
- 33 I upërgjeqnë ati, Jemi far' e Avraamit, edhe asnjeriu nuk' i jemi bërë kurrë shërbëtorë;
- 34 qysh thua ti, Se dotë bëheni të-liruarë? Jisuj u upërgjeq atyre, Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve, Se kushdo që bën
- 35 fajinë, shërbëtuar' i fajit është. Edhe shërbëtori nukë mbetetë ndë shtëpit për gjithë
- 36 jetënë; po biri mbetetë për gjithë jetënë. Ndë u liroftë pra juve Biri, me të-vërtetë dotë
- 37 jeni të-liruarë. E di se jeni far' e Avraamit; po kërkoni të më vrisni, sepse fjala ime
- 38 nukë zë vënt ndër ju. Unë flas ç' kam parë përënë t' im Eti; edhe ju gjithashtu bëni ç'
- 39 keni parë përënë atit t' uaj. I upërgjeqnë e i thanë, Ati ynë është Avraami. Jisuj u thot' atyrë, Po të ishitë bij t' Avraamit, punërat' e

40 Avraamit dotë bënitë. Po ndashti kërkoni të  
 më vrisni, njeri që u kam folurë të-vërtetënë,  
 që dëgjova prej Perëndisë; Avraami këtë nuk'  
 41 e bëri. Ju bëni punërat' e atit t' uaj.

I thanë pra ati, Neve s' kemi lindurë prej  
 42 kurvërie; një atë kemi, Perëndinë. Jisuj pra  
 u tha atyre, Po të ishte Perëndia ati juaj,  
 dotë më donitë; sepse unë prej Perëndisë  
 dolla, edhe prej ati vinj; sepse nuk' arthçë prej  
 43 vetëhesë s' ime, po ay më dërgoj. Përse nukë  
 njihni të-foluritë t, im? sepse nukë munt të  
 44 dëgjoni fjalënë t' ime. Ju jeni prej djallit, atit  
 t' uaj edhe doni të bëni dëshërimet' e atit  
 t' uaj. Ay ishte që ndë kryet njeri-vrasës,  
 edhe nukë qëndron ndë të-vërtetët; sepse  
 të-vërtetë nukë ka tek ay. Kur flet gënje-  
 shtrënë, flet nga të-tijatë; sepse është gënje-  
 45 shtar, edhe i at' i asaj, i gënjeshtresë. Po mua,  
 46 sepse them të-vërtetënë, nukë më besoni. Cili  
 prej jush më shan për faj? po ndë them të-  
 47 vërtetënë, përse s' më besoni ju? Ay që është  
 prej Perëndisë, fjalët' e Perëndisë dëgjon;  
 përandaj ju nukë dëgjoni, sepse prej Perën-  
 disë nukë jeni.

48 Judhenjtë pra upërgjeqnë e i thanë, Nukë  
 themi mirë ne, se ti je Samarit, edhe diall  
 49 ke? Jisuj upërgjeq, Unë djall s' kam, po nde-  
 50 ronj t' im Atë, edhe ju më çnderoni. Edhe  
 unë s' kërkonj lavdinë t' ime; është ay që  
 51 kërkon e që gjykon. Me të-vërtetë, me të-

- vërtetë po u them juve, Ndë ruajtë ndonjë fjalënë t'ime, nukë dotë shohë vdekje për  
52 gjithë jetënë. Judhenjtë pra i thanë, Ndashti e muarmë vesh, se ke djall. Avraami vdiq edhe profitëritë, edhe ti thua, Ndë ruajtë ndonjë fjalënë t'ime, nukë dotë ngjëronetë  
53 vdekje për gjithë jetënë. Mos je ti më i-math se ati ynë Avraam, i-cili vdiq? edhe profitëritë vdiqnë; ti cilinë e bën vetëhenë t'ënde?  
54 Jisuj upërgjeq, Unë ndë lavduronj vetëhenë t'ime, lavdia ime s'është' asgjë; im Atë është' ay që me lavduron, për të-cilinë ju thoni se  
55 është' Perëndia juaj; Edhe s' e keni njohurë, po un' e njoh; edhe ndë thënça se nuk' e njoh, dotë jem posi ju, gënjeshtar; po e njoh,  
56 edhe ruanj fjalën' e ati. Avraami ati juaj gëzzonej të shohë ditënë t'ime; edhe e pa, e ugëzua.
- 57 Judhenjtë pra i thanë, Pesë-dhjetë vjet edhe  
58 s'i ke, edhe Avraaminë e ke parë? Jisuj u tha atyre, Me të-vërtetë me të-vërtetë, po u them juve, Para se të lintnjë Avraami, unë jam.
- 59 Ngritnë pra gurë që t'i hithninë kundr' ati; po Jisuj ufsheh, edhe dolli nga hieroreja, edhe shkoj ndëpër mest t' atyreve; edhe kështu iku.

### Krye 9.

- 1 Edhe dyke shkuarë, pa një njeri të-ver-
- 2 bërë që prej të-lindurit. Edhe nxënësit' e ati



- e pyetnë, dyke thënë, Ravvi, cili fëjeu, ky apo prindërit' e ati, që të lintnjë i-verbërë?
- 3 Jisuj upërgjeq, As ky fëjeu, as prindërit' e ati; po që të dëftenenë punërat' e Perëndisë
- 4 tek ay. Unë duhetë të punonj punërat' e ati që më dërgoj, gjersa është ditë: vjen natë, kur asdonjë s' munt të punonjë. Sa të jem ndë botët, jam drit' e botësë.
- 6 Passi tha këto, pshtyti përdhe, edhe bëri baltë prej pshtymësë, edhe leu syt' e të-verbërit
- 7 me baltënë; Edhe i tha ati, Shko e lahu ndë pellkt të Silloamit, (që e-kthyarë do më thënë i-Dërguarë). Vate pra e ula, edhe erdhi dy-
- 8 ke parë. Fëqinjtë pra, edhe ata që e shihninë më përpara se ishte i-verbërë, thoshinë, Nuk'
- 9 është ky ay që rrinte e lypënte? Të-tjerë thoshinë, Se ky është; edhe të-tjerë, Se i
- 10 shëmbëllen; *po* ay thoshte, Se unë jam. I
- 11 thoshinë pra, Qysh t' uhapnë sytë? Ay upërgjeq e tha, *Një* njeri që thuhetë Jisu bëri baltë, edhe më leu sytë, edhe me tha, Shko ndë pellkt të Silloamit, edhe lahu. Edhe si
- 12 vajta e ulava, hapa sytë. I thanë pra, Ku është' ay? Thotë, Nukë di.
- 13 E bjenë te Farisenjtë atë që *ishte* njëherë
- 14 i-verbërë. Edhe ishte e-shëtunë, kur bëri
- 15 baltënë Jisuj, edhe i hapi ati sytë. Përsëri pra e pyetnin' edhe Farisenjtë, Qysh hapi sytë? Edhe ay u tha atyre, Vuri baltë mbi
- 16 syt të mi, edhe ulava, edhe shoh. Ca pra

- prej Farisenjet thoshinë, Ky njeri nuk' është nga Perëndia, sepse nukë ruan të-shëtunënë. Të- tjerë thoshinë, Qysh munt të bënë të-tilla çudira *një* njeri fajtuar? Edhe ishte një
- 17 çarje ndër mest t' atyreve. I thonë përsëri të-verbërit, Ti ç' thua për atë, sepse te hapi sytë? Edhe ay tha, Se është profit.
- 18 Judhenjtë pra nukë besuanë për atë, se ishte i-verbërë, edhe hapi sytë, gjersa thë-
- 19 rritnë prindërit' e ati që i uhapnë sytë; Edhe i pyetnë dyke thënë, Ky është biri juaj, për të-cilinë ju thoni se ka lindurë i-verbërë?
- 20 qysh sheh pra ndashti? Prindërit' e ati u upërgjeqnë atyre, e thanë, E dimë se ky është
- 21 biri ynë, edhe se ka lindurë i-verbërë; Po qysh sheh ndashti nukë dimë; a cili i hapi sytë, neve nukë dimë; ay moshë ka, pyet-e-ni; ay dotë flase për vetëhen' e ti.
- 22 Këto thanë prindërit' e ati, sepse kishinë frikë nga Judhenjtë; sepse Judhenjtë ndashti kishinë lidhurë fjalë, që ay që t'a rrëfenjë
- 23 për Krisht të bënetë jashtë sinagogjisë. Përandaj prindërit' e ati thanë, Se moshë ka, pyet-e-ni.
- 24 Thirrën pra për-së-dyti njerinë, që kishte qënë i-verbërë, edhe i thanë, Ep-i lavdi Perëndisë; neve e dimë se ky njeri është fajtnar.
- 25 Ay pra upërgjeq e tha, Nd' është fajtuar, nuk' e di; një di, se qeshë i-verbërë, edhe ndashti
- 26 shoh. Edhe i thanë përsëri, Ç' të bëri? qysh

27 t' i apë sytë? U upërgjeq atyre, Ndashti u  
thashë juve, edhe nukë dëgjuatë; ç' doni  
përsëri të dëgjoni? mos edhe juve doni të  
bëhi nxënës t' ati?

28 E shanë pra, edhe thanë, Ti je nxënës i  
29 ati; po neve jemi nxënës të Moisiut. Neve  
dimë se Perëndia i foli Moisiut; po këtë  
30 nuk' e dimë nga është. Njeriu upërgjeq e  
u tha atyre, Ndë këtë me të-vërtetë është  
çudia, se ju s' e dini nga është, edhe mua  
31 më hapi sytë. Edhe e dimë, se Perëndia  
nukë dëgjon fajtorë; po ndë pastë ndonjë  
frikë Perëndie, edhe të bënë dashurimn'  
32 e ati, këtë e dëgjon. Që prej kryes' së jetësë  
nuk' është dëgjuarë, se hapi njeri syt' e njëj  
33 që ka lindur' i-verbërë. Ndë mos ishte ky  
nga Perëndia, nukë dotë muntte të bënte  
34 asgjë. Upërgjeqnë e i thanë, Ti ke lindur' i-  
tërë ndë faje, edhe ti na mëson? edhe e  
nxuarnë jashtë.

35 Jisuj dëgjoj, se e nxuarnë jashtë; edhe si  
e gjeti, i tha, I beson të Birit të Perëndisë?  
36 Ay upërgjeq e tha, Cili esht' ay, Zot, që t' i  
37 besonj? Edhe Jisuj i tha, Edhe e ke parë,  
38 edhe ay është që flet baskë me ty. Edhe ay  
tha, Besonj o Zot, edhe i ufal.

39 Pastaj Jisuj tha, Unë për gjyq kam ar-  
dhurë ndë këtë botë, që të shohën' ata që  
nukë shohënë, edhe të bënenë të-verbërë  
40 ata që shohënë. Edhe prej Farisenjet sa ishin

në bashkë me atë i dëgjuanë këto, edhe i  
 41 thanë, Mos jemi edhe neve të-verbërë? Jisuj  
 u tha atyre, Po të ishitë të-verbërë, nukë  
 dotë kishitë faj; po tas .ti thoni, Se shohëmë;  
 faji juaj pra mbetetë.

### Krye 10.

1 Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them  
 juve, Ay që nukë hyn nga dera ndë oborrt  
 të dhënvët, po hipën që gjetkë, ay është vje-  
 2 dhës edhe kursar. Po ay që hyn nga dera,  
 3 është bariu i dhënvët. Këti i hap derënë por-  
 tari; edhe dhëntë dëgjonjënë zërin' e ati; edhe  
 thërret dhënt' e ti me emërë, edhe i nxjer,  
 4 Edhe kur nxjer dhënt' e ti, vete përpara a-  
 tyreve; edhe dhënt' i venë prapa, sepse e  
 5 njohënë zërin' e ati. Po të-huajit nukë dot' i  
 venë prapa, po dot' ikënjënë prej ati; sepse  
 nuk' e njohënë zërin' e të-huajvet.

6 Këtë paravoli u tha atyre Jisuj; po ata  
 nukë kupëtuanë ç' ishinë këto që u fliste  
 atyre.

7 Jisuj pra u tha atyre përsëri, Me të-vër-  
 tetë, me të-vërtetë po u them juve, se unë  
 8 jam dera e dhënvët. Gjithë sa erthnë para  
 meje janë vjedhës edhe kursarë; po dhëntë  
 9 nuk' u dëgjuan' atyre. Unë jam dera; me anë  
 t' ime ndë hyftë ndonjë, dotë shpëtonjë, edhe  
 dotë hynjë edhe dotë dalë, edhe dotë gjenjë  
 10 të-kulloturë. Vjedhësi nukë vjen, veç për të

vjedhur' e për të therur' e për të prishurë;  
un' arthçë, që të kenë jetë, edhe t'a kenë me  
11 të-tepërë. Unë jam bariu i-mirë; bariu i-mirë  
12 vë jetën' e ti për dhëntë. Po ay që është i-  
pajtuarë, edhe që s' është bari, të-cilit dhëntë  
s' janë të-tijatë, sheh ujkunë dyke ardhurë,  
edhe lë dhënt' e ikën, edhe ujku i rrëmben  
13 ato, edhe përndan dhëntë. Edhe i-pajtuari  
ikën, sepse është i-pajtuarë, edhe s' do të  
14 dijë për dhëntë. Unë jam bariu i-mirë, edhe  
njoh të-mijatë, edhe njihem prej të-mijavet,  
15 Sikundrë me nje i Ati, edhe un' e njoh A-  
16 tinë; edhe vë jetënë t' imë për dhëntë. Kam  
edhe të-tjera dhën, të-cilatë s' janë prej këti  
oborri; duhetë t' i mbleth edhe ato; edhe  
dotë dëgjonjënë zënë t' im; edhe dotë bënë të  
17 një tufë e një bari. Përandaj Ati më do, sepse  
uuë vë jetënë t' ime, që t'a marr përsëri.  
18 Asndonjë s' e ngre prej meje, po un' e ve  
prej vetiu; kam pushtet t'a vë, edhe kam  
pushtet t'a marr përsëri. Këtë porosi mora  
prej t' im Eti.

19 Përsëri pra ubë një çarje ndër mest të  
20 Judhenjet për këto fjalë. Edhe shumë *veta*  
prej atyreve thoshinë, Djall ka, edhe është i-  
21 shkalluarë; ç' e dëgjoni? Të-tjerë thoshinë,  
Këto fjalë nukë janë *fjalë* të-djallosuri; mos  
munt djalli t' u hapnjë sytë të-verbëret?

22 Edhe ubë *e-kremteja* e të-shënjtëruarit të  
hieroresë ndë Jerusolim, edhe ishte dimër.

- 23 Edhe Jisuj ecënte ndë hieroret, ndë ka-  
24 maret të Sollomonit. Judhenjtë pra e qerthë-  
lluanë, edhe i thoshinë, Gjer kur mban ndë  
dyschim shpirtinë t' ënë? ndë je ti Krishti, na  
thuj ndër sy.
- 25 Jisuj u upërgjeq atyre, U thashë juve,  
edhe nukë besoni. Punëratë që bënë unë mb'  
emërit të t' im Eti, këto dëshmonjënë për  
26 mua. Po ju nukë besoni; sepse nukë jini  
27 prej dhënvët të mia. Sikundrë u thashë juve,  
dhënt' e mia dëgjonjënë zënë t' im, edhe un'  
28 i njoh; edhe më vinjenë pas. Edhe un' u ap  
atyre jetë të-përjetëshme; edhe nukë dotë  
humbasënë për *gjithë* jetënë, edhe nukë dot'  
i rrëmbenjë njeri ato prej dorësë s' ime.
- 29 Im Atë, që m' i ka dhënë, është më i-  
math se të-gjithë; edhe asnjë s' munt t' i  
30 rrëmbenjë prej dorës' së t' im Eti. Unë edhe  
Ati jemi një.
- 31 Përsëri pra Judhenjtë rroknë gurë, që t' i  
bininë me gurë.
- 32 Jisuj u upërgjeq atyre, Shumë punëra të-  
mira u rrëfeva juve prej t' im Eti; për ç'  
33 punë nga ato më bini me gurë? Judhenjtë i  
upërgjeqnë, dyke thënë, Nukë të bjemë me  
gurë për punë të-mirë, po për vllasfimi,  
edhe sepse ti, ndonëse je njeri, e bën vetëhenë  
34 t' ende Perëndi. Jisuj u upërgjeq atyre, Nuk'  
është shkruarë ndë nomt t' uaj, „Unë thashë,  
35 Jeni perëndira?“ Ndë qoftë, se quajti perëndira

ata, mbë të-cilët ubë fjal' e Perëndisë, (edhe  
 36 shkronja s' munt të bjerë poshtë), Për atë  
 që e shënjtëroj Ati, edhe e dërgoj ndë botët,  
 ju thoni, Se *ti* vllasimis, sepse thashë, Jam i  
 37 Bir' i Perëndisë? Ndë mos bënj punërat' e t'  
 38 im Eti, mos më besoni; Po ndë bënj, edhe  
 ndë mos më besoni mua, beso-u-ni punëravet;  
 që të njihni e të besoni, se Ati *është* tek  
 unë, edhe unë tek ay.

39 Kërkoninë pra përsëri t'a zënë; po dolli  
 nga dora e atyreve.

40 Edhe shkoj përsëri përtej Jordhanit, ndë  
 vëntt ku ishte Joani përpara dyke pagëzuarë;  
 41 edhe mbeti atje. Edhe shumë *veta* erthnë  
 tek ay, edhe thoshinë, Se Joani nukë bëri  
 asndonjë çudi; po gjithë sa tha Joani për  
 këtë, ishinë të-vërteta. Edhe atje shumë *veta*  
 i besuan' ati.

### Krye 11.

1 Edhe ishte një *njeri* i-sëmurë, *që quhej*  
 Llazar, nga Vithania, nga fshati i Mariësë  
 2 edhe i Marthësë së motrës' s' asaj. (Edhe  
 Maria ishte ajo që leu Zotinë me vaj ere,  
 edhe fshiu këmbët' e ati me flokët' e saj,  
 3 se-cilësë i vëllaj, Llazari, ishte sëmurë). Të  
 motëratë pra dërguanë, dyke thënë, Zot, na  
 ay që do *ti* tek është sëmurë.

4 Edhe Jisuj kur dëgjoj tha, Këjo sëmun-  
 dje nuk' është për vdekje, po për lavdin' e

Perëndisë, që të lavduronet' i Bir' i Perëndisë me anë t' asaj.

5 Edhe Jisuj donte Marthën' edhe të motë-  
6 rën' e asaj edhe Llazarinë. Kur dëgjoj pra  
se është sëmurë, atëhere mbeti dy dit mb'  
7 atë vënt ku ishte. Pastaj pas kësaj u thotë  
8 nxënëset, Letë vemi prapë ndë Judhe. Nxënë-  
sit' i thorë, Ravvi, ndashti Judhenjtë kërko-  
ninë të të vrisinë me gurë, edhe përsëri vete  
9 atje? Jisuj upërgjeq, A nukë ka dy-mbë-dhje-  
të orë dita? nd' ectë ndonjë ditënë, nukë  
pengonetë, sepse sheh dritën 'e kësaj bote.  
10 Po nd' ectë ndonjë natënë, pengonetë, sepse  
s' ka dritë nd' atë.

11 Këto tha, edhe pastaj u thot' atyre, Llazari  
12 miku ynë flejti; po vete që t'a sgjonj. Nxënësit'  
e ti i thanë pra, Zot, ndë flejti, dotë shpëto-  
13 një. Po Jisuj kishte thënë për vdekjen' e a-  
ti; po ata pandehnë se thotë për të-flejturit'  
14 e gjumit. Atëhere pra Jisuj u tha atyre fa-  
15 qeza, Llazari vdiq. Edhe gëzonem për ju, që  
të besoni, sepse nukë qesh' atje; po letë ve-  
16 mi tek ay. Thomaj pra, që thuhetë binjak,  
u tha bashkë-nxënëset të ti, Letë vemi edhe  
neve, që të vdesëmë bashkë me atë.

17 Kur erdhi pra Jisuj, e gjeti se kishte  
ndashti katrë dit ndë varrt.

18 Edhe Vithania ishte afërë Jeruslimit si-  
19 ndonja pesë-mbë-dhjetë stadhe. Edhe shumë  
*veta* prej Judhenjet kishin' ardhurë te Mar-



tha e te Maria, që t' i ngushëlloninë për të  
20 vëllan' e atyreve. Martha pra kur dëgjoj, se  
po vjen Jisuj, i dolli përpara; edhe Maria  
rrinte ndë shtëpit.

21 Martha pra i tha Jisujt, Zot, t' ishnye këtu,  
22 im vëlla nukë dotë vdiste. Po edhe ndashti  
e di, se sa t' i lypënjç Perëndisë, dotë t' i  
23 apë Perëndia. Jisuj i thot' asaj, Yt vëlla dotë  
24 ngjalletë. I thot' ati Martha, E di se dotë  
ngjalletë ndë të-ngjallurit ndë ditët të-pastaj-  
25 me. Jisuj i tha, Unë jam të-ngjallurit' edhe  
jeta; ay që më beson, edhe ndë vdektë, dotë  
26 rronjë. Edhe kushdo që rron edhe më beson,  
nukë dotë vdesë për gjithë jetënë. A e beson  
27 këtë? I thot' ati, Po, Zot, unë kam besuarë,  
se ti je Krishti, i Bir' i Perëndisë, që ke ar-  
dhurë ndë botët.

28 Edhe ajo si tha këto, vate e thërriti  
fshehuraj Mariënë të motërën' e saj, e i tha,  
Mësonjësi është këtu, edhe po të thërret.  
29 Ajo kur dëgjoj, ngrihetë çpejt, edhe vjen tek  
30 ay. (Jisuj edhe s' kishte ardhurë ndë fshatt,  
po ishte ndë atë vënt që i dolli përpara  
31 Martha.) Judhenjtë pra që ishinë bashkë me  
atë ndë shtëpit edhe e ngushëlloninë, kur  
panë Mariënë se ungrit çpejt e dolli, i vanë  
prapa, dyke thënë, Se po vete ndë varrt për  
të qar' atje.

32 Maria pra si erdhi atje ku ishte Jisuj,  
kur e pa atë, i ra ndër këmbë, dyke thën'

ati, Zot, nd' ishnje këtu, vëllaj nukë dotë  
33 më vdiste. Jisuj pra kur pa atë dyke qarë,  
edhe ata Judhenjtë që kishin' ardhurë bashkë  
me atë dyke qarë, psherëtiti ndë shpirtt të  
34 ti, edhe utrumbullua, E tha, Ku e keni vënë?  
35 I thonë, Zot, eja e shih. 36) Jisuj derdhi lot.  
37 Judhenjtë pra thoshinë, Shih sa e donte. Po ca  
prej atyre thanë, Nukë muntte ky që hapi syt' e  
të-verbërit të bënte, që edhe ky të mos vdiste?  
38 Jisuj pra përsëri dyke psherëtiturë ndër  
vetëhe vjen ndë varrt. Edhe ishte një shpe-  
39 llë, edhe mbi atë ishte vënë një gur. Jisuj  
thotë, Ngrini gurinë. Martha, e motëra e të-  
vdekurit, i thotë, Zot, qelbetë ndashti; sepse  
40 është katrë ditsh. Jisuj i thot' asaj, Nukë të  
thashë, se ndë besofsh, dotë shohç lavdin' e  
41 Perëndisë? Ngritnë pra gurinë, (ku ishte vë-  
në i-vdekuri). Edhe Jisuj ngriti sytë përtpjetë,  
e tha, Atë, të falem ndersë, se më dëgjove.  
42 Edhe un' e dinjam, se përherë më dëgjon;  
po *këtë* e thashë për *këtë* llauzinë që rri *këtu*  
rreth, që të besonjënë, se ti më dërgove.  
43 Edhe si tha këto, thërriti me zë të-math,  
44 Llazar, dil jashtë. Edhe i-vdekuri dolli, lidhu-  
rë këmbët' e duartë me rripa pëlhure; edhe  
faqeja e ati ishte pshtjellë me rizë. Jisuj u  
thot' atyre, Sgjidh-e-ni, edhe lër-e-ni të vejë.  
45 Shumë *veta* pra prej Judhenjvet, që ki-  
shin' ardhurë te Maria, edhe panë sa bëri  
46 (Jisuj), i besuanë. Po ca prej atyre vanë të

Farisenjtë, edhe u than' atyre sa bëri Jisuj.  
47 Kryepriftëritë pra edhe Farisenjtë mblo-  
thnë bashkëndënje, edhe thoshinë Ç' të bëj-  
48 në? se ky njeri bën shumë çudira. Ndë e lën-  
çim' atë këgtu, të-gjithë dot'i besonjënë; edhe  
dotë vijnë Romanëtë, edhe dotë prishnjënë  
49 edhe vëndinë t' ënë edhe kombinë. Edhe një  
nga ata, Kaiafa, që icete kryeprift i ati viti, u  
50 tha atyre, Ju nukë dini asgjë, As nukë men-  
doneni, se është mirë për ne të vdesë një  
njeri për llauzinë, edhe të mos humbasë gji-  
51 thë kombi. Edhe këtë nuk' e tha prej vetëhes'  
së ti, po dyke qënë kryeprift i ati viti, pro-  
fitepsi se Jisuj kishte për të vdekurë për  
52 kombinë; Edhe jo për kombinë vetëmë, po  
edhe që të mbledhë mbë një të bijt' e Perën-  
disë që ishinë përndarë.  
53 Që mb' atë ditë pra bënë këshillë që t'a  
54 vrasënë. Përandaj Jisuj nuk' ecënte më fa-  
qeza ndëpër Judhenjtë, po shkoj s' andejmi  
ndë një vënt afërë shkretëtirësë, ndë një qy-  
tet që thuhetë Efraim, edhe atje shkonte ko-  
hënë bashkë me nxënësit' e ti.  
55 Edhe ishte afërë pashka e Judhenjet; edhe  
shumë *veta* prej *ati* vëndi hipnë ndë Jeru-  
salim përpara pashkësë, që të qëroninë ve-  
56 tëhen' e tyre. Kërkoninë pra Jisunë, edhe i  
thoshinë njëri tjtërit dyke ndënjurë ndë  
hieroret, Ç' u duketë juve? se nukë dotë vi-  
57 një ndë të-kremtet? Edhe kryepriftërit' e Fa-

risenjtë kishinë porositurë, ndë e marrtë vesh ndonjë se ku është, t'apë zë, që t'a zënë.

### Krye 12.

- 1 Jisuj pra gjashtë dit përpara pashkësë erdhi ndë Vithani, ku ishte Llazari që pat vdekurë, të-cilin' e kishte ngjallurë prej së-
- 2 vdekurish. Edhe i bënë darkë atje; edhe Martha shërbente; edhe Llazari ishte një prej atyre që rrininë ndë mësallët bashkë me atë.
- 3 Atëhere Maria mori një litrë vaj ere prej nardhi të-papërzjerë shumë të-shtrënjtë, edhe leu këmbët' e Jisujt, edhe me flokët' e saj fshiu këmbët' e ati; edhe stëpia umbush me erën' e vajit të erësë.
- 4 Një pra nga të dy-mbë-dhjetë nxënësit' e ati, Judhë Iskarioti, *i bir'* i Simonit, ay që
- 5 dot' a trathëtonte, thotë, Përse të mos shitej këta vaj ere tre qint dhinarë, e të epej ndë-
- 6 për të-vobeqt? Edhe këtë e tha, jo se donte të dinte për të-vobeqtë, po sepse ishte vjedhës, edhe kishte kuletën' e aspravet, edhe
- 7 mbante ç' viheshinë *nd' atë*. Jisuj pra tha, Lër-e; *se* e ruajti për ditën' e të-kallurit t'im
- 8 ndë varrt. Sepse të vobeqtë i keni përherë bashkë me vetëhenë t' uaj, po muaj nukë më keni përherë.
- 9 Shumë gjindje pra prej Judhenjet muar-në vesh se është' atje; edhe erthnë jo për Jisunë vetëmë, po që të shohën' edhe Llazari-

në, të-cilin' e kishte ngjallurë prej së-vde-  
10 kurish. Po kryepriftëritë bënë këshillë, që të  
11 vrasën' edhe Llazarrë; Sepse shumë veta prej  
Judhenjet vininë për atë, edhe i besoninë  
Jisujt.

12 Mbë të-nesërmet shumë gjindje që kishin'  
ardhurë ndë të-kremtet, kur dëgjuanë, se  
13 vjen Jisuj ndë Jerusalem, Muarnë dega hur-  
mash, edhe duallnë përpara t' a presënë,  
edhe thërrisninë, Hosanna, i-bekuar' është ay  
që vjen mb' emërë të Zotit, mbreti i Israilit.

14 Edhe Jisuj gjeti një pulisht, edhe ndënji  
15 mbi atë, sikundrë është shkruarë, „Mos ki  
frikë, bij' e Sionësë, na mbreti yt tek po  
vjen dyke ndënjurë mbi pulisht gomareje.“

16 Edhe nxënësitë nukë kupëtuanë këto ndë  
kryet; po kur ulavdurua Jisuj, atëhere u ra  
ndër mëntt atyre, se këto ishinë shkruarë  
për atë, edhe se këto j' a bënë ati.

17 Gjindja pra që ishte bashkë me atë dë-  
shmonte, se thirri Llazarinë nga varri, edhe e  
18 ngjalli nga të-vdekuritë. Përandaj edhe gjin-  
dja i dolli përpara, sepse dëgjoj, se ay kishte  
19 bërë këtë çudi. Farisenjtë pra i thanë njëri  
tjatërit, A shihni ju, se nukë bëni as një  
dobi? na bota tek vate prapa ati.

20 Edhe ishinë ca Grekër ndër mest t' atyre-  
ve që kishinë hipurë për të falurë ndë të-krem-  
21 tet. Këta pra erthnë te Filippi që ishte prej  
Vithsaidhas' së Galilesë, edhe i luteshinë,

dyke thënë, Zot, duamë të shohëmë Jisunë.  
 22 Filippi vjen e i thotë Andhreit; edhe përsëri  
 23 Andhreu edhe Filippi i thonë Jisujt. Edhe  
 Jisuj u upërgjeq atyre, dyke thënë, Erdhi ora  
 24 që të lavduronet' i Bir' i nderiut. Me të-vërtetë,  
 me të-vërtetë po u them juve, Ndë mos rëntë  
 koq'e grurit ndë dhet e të vdesë, ajo mbetetë  
 25 e-vetëmë; po ndë vdektë, bie shumë pemë. Ay  
 që do jetën' e ti dot'a humbasë; po ay që mër-  
 zit jetën' e ti ndë këtë botë, dot'a ruanjë për  
 26 jetë të-përjetëshme. Ndë më shërben ndonjë,  
 letë më vinjë pas; edhe ku të jem unë, atje  
 dotë jetë edhe shërbëtori im; edhe ndë qoftë  
 se më shërben ndonjë, Ati dot'a nderonjë.  
 27 Ndashti shpirti im është' i-trumbulluarë; edhe  
 ç' të them? Atë, shpëto-më nga kjo orë. Po  
 28 përandaj erdha ndë këtë orë. Atë, lavduro  
 emërinë t' ënt.

Erdhi pra një zë nga qielli, Edhe e lav-  
 29 durova, edhe përsëri dot'a lavduronj. Gjindja  
 pra që kishe ndënjurë edhe dëgjoj zënë,  
 thoshte, se ubë bumbullimë; të-tjerë thoshi-  
 në, se ëngjëll i foli ati.

30 Jisuj upërgjeq e tha, ky zë nuk' ubë për  
 mua, po për ju. Ndashti ështëë gjyqi i kësaj  
 bote; ndashti urdhërtari i kësaj bote dotë hi-  
 32 dhetë jashtë. Edhe unë nd' ungrisha lart nga  
 Ëeu, dot' i heq të-gjithë pas vetëhesë s'ime.  
 33 —(Edhe këtë e thoshte dyke dëftyerë me ç'  
 farë vdekjeje dotë vdiste.)

34 Gjindja i upërgjeq, Neve kemi dëgjuarë  
nga nomi, se Krishti mbetetë për jetën' e  
*jetësë*; qysh thua pra ti, se i Bir' i nderiut  
duhetë të ngrihetë lart? cili është ky i Bir'  
35 i njeriut? Jisuj pra u tha atyre, Edhe pakzë  
kohë është drita bashkë me ju. Ecëni gjersa  
keni dritënë, që të mos u zërë juve errësira;  
sepse ay që ecën nd'errësirët, nukë di se  
36 ku vete. Gjersa kini dritënë, t'i besoni dri-  
tësë, që të bëneni bij të dritësë — Këto foli  
Jisuj, edhe iku e ufsheh prej atyreve.

37 Po ndonëse bëri kaqë çudira përpara aty-  
38 reve, nuk' i besuanë; Që të mbushetë fjal' e  
profitit Isai që tha, „Zot, kush i besoj lëçi-  
tjesë s' anë? edhe mbë cilinë krahu i Zotit  
39 usbulua?“ Përandaj nukë munt të besoninë,  
40 sepse përsëri Isaia tha, „Verboj syt' e atyreve,  
edhe ashpëroj zëmërën' e atyreve, që të mos  
shohënë me sytë, edhe të mos kupëtonjënë  
me zëmërnë, edhe të kthenënë, e t'i shëronj  
41 ata.“ Këto tha Isaia, kur pa lavdin' e ati,  
edhe foli për atë.

42 Po edhe prej të-parëvet shumë *veta* be-  
suanë; po nga *frik' e* Farisenjet nukë rrëfe-  
ninë, që të mos bënenë jashtë sinagogjisë;  
43 Sepse deshnë lavdin' e njerëzet më tepërë se  
lavdin' e Perëndisë.

44 Edhe Jisuj bërtiti e tha, Ay që më beson  
mua, nukë më beson mua, po ati që më  
45 dërgoj; Edhe ay që më vë re mua, vë re

46 atë që më dërgoj. Unë kam ardhurë dritë ndë  
 botët, që të mos mbetetë nd' errësirët kush-  
 47 do që të më besonjë. Edhe ndë dëgjoftë  
 ndonjë fjalët' e mia, edhe të mos besonjë,  
 unë nuk' e gjykonj; sepse nuk' erdha të gjy-  
 48 konj botënë, po që të shpëtonj botënë. Ay  
 që më heth poshtë, edhe nukë pret fjalët' e  
 mia, ka se kush t'a gjukonjë; fjala që fola,  
 ajo dot'a gjykonjë ndë ditët të-pastajme.  
 49 Sepse unë nukë fola prej vetiu, po Ati që  
 më dërgoj, ay më dha porosi, ç'të them, e  
 50 ç'të flas; Edhe e di, se porosia e ati është  
 jet' e-përjetëshme; sa pra flas unë, sikundrë  
 më ka thënë Ati, kështu flas.

### Krye 13.

- 1 Edhe përpara së-kremtes' së pashkësë,  
 Jisuj dyke diturë se i erdhi ora, që të shkonjë  
 prej kësaj bote tek Ati, pasi deshi të-tijtë  
*që ishinë* ndë botët, gjer ndë funtt i deshi ata.
- 2 Edhe si shkoj darka, (edhe djalli ndashti  
 kishte vënë ndë zëmërët të Judhë Iskariotit,  
 3 *të birit* të Simonit, që t'a trathëtonjë;) Jisuj,  
 dyke diturë se Ati j'a ka dhënë ndë duart  
 të-gjitha, edhe se nga Perëndia dolli edhe te  
 4 Perëndia vete, Ngrihetë nga darka, edhe  
 svesh rrobat' e *tia*, edhe mori një *pëlhurë* të-  
 5 lirtë e ngeshi vetëhen' e ti. Pastaj vë ujë  
 ndë legen, edhe zuri t' u lanjë këmbëtë



nxënëset, edhe t' u'a fshinjë me pëlhurën' e-  
lirtë, me të-cilënë ishte ngjeshurë.

6 Vjen pra te Simon Pjetri; edhe ay i thote,  
7 Zot, ti më lan këmbëtë? Jisuj upërgjeq e i  
tha, Atë që bënj unë ti nuk' e di ndashti,  
8 po dot'a njohç paskëtajthi. Pjetri i thotë,  
Nukë dotë më lanç këmbëtë për *gjithë* je-  
tënë. Jisuj i upërgjeq, Nde mos t' i lafsha,  
9 nukë ke pjesë me mua. Simon Pjetri i thotë,  
Zot, jo këmbët' e mia vetëmë, po edhe duartë,  
10 edhe kryetë. Jisuj i thotë, Ay që është' i-larë  
s' ka nevojë veç të lanjë këmbëtë, po ështëë  
gjith' i-qëruarë; edhe ju jini të-qëruarë, po  
11 jo të-gjithë.—Sepse e dinte atë që dot'a trathë-  
tontë; përandaj tha, Nukë jeni të-gjithë të-  
qëruarë.

12 Passi u lau pra atyre këmbëtë, edhe mori  
rrobat' e tia, ndënji përsëri, e u tha atyre, E  
13 dini se ç u bëra juve? Ju më thërrisni, Mëso-  
njës edhe Zot; edhe mirë thoni, sepse Jam,  
14 Nd' u lava pra juve këmbëtë unë Zoti edhe  
Mësonëjsi, edhe ju duhetë t' i lani këmbëtë  
15 njëri tjatërit. Sepse u lashë shëmbëllë juve,  
që të bëni edhe ju, sikundrë u bëra unë ju-  
16 ve. Me të-vërtetë, me te-vërtetë po u them  
juve, se shërbëtori nuk' ështëë më i-math se i  
zoti, as i-dërguari më i-math se ay që e ka  
17 dërguarë. Ndë i dini këto, jeni të-lumurë,  
18 ndë i bëni. Nukë them *këto* për ju të-gjithë;  
unë di cilëtë kam sgjedhurë; pa që të mbu-

shetë shkronja „Ay qe hante bukënë bashkë me mua, ngriti thënbrën' e ti kundrë meje.“

19 Që tashti po u'a them juve *këtë*, përpara se të bënetë, që të besoni, kur të bënetë, se  
20 unë jam. Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve, ay që pret atë që të dërgonj *unë*, ka priturë mua; edhe ay që të presë mua, ka pritur' atë që më dërgoj.

21 Jisuj passi tha këto, utrumbullua ndë shpirtt, edhe dëshmoj e tha, Me te-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve, se një prej jush  
22 dotë më trathëtonjë. Nxënësitë pra shikoninë njëri tjatrinë, e s' dininë për cilinë thotë.  
23 Edhe një nga nxënësit' e ati ishte pshteturë  
24 ndë gjit të Jisujt, të-cilinë Jisuj e donte. Simon Pjetri pra i bëri me shënjë, që t'a pyesë,  
25 cili është' *ay*, për të-cilinë thotë. Edhe ay ra mbë krahëruart të Jusujt. e i thotë, Zot, cili  
26 është' *ay*? Jisuj përgjigjetë, Ay ështëë, që unë kur të ngjyenj kafshitënë t' j'a ap. Edhe ngjeu kafshitënë e j'a ep Judhë Iskariotit, të  
27 *birit* të Simonit. Edhe pas kafshitësë, atëhere Satanaj hyri tek ay. Jisuj pra i thotë, Ç'  
28 ke për të bërë, bëj-e më çpejt. Po këtë asndonjë prej atyreve qe kishinë ndënjurë ndë mësallët nuk' e kupëtoj përse i tha ati.  
29 Sepse ca pandehninë se Jisuj i thotë, Blij ç' na duhetë për të-kremtenë, a t' u apë gjë të-vobeqvet; sepse Judha kishte kuletën' e aspravet.

30 Ay pra si mori kafshitënë, dolli jashtë  
 31 për-një-here; edhe ishte natë. Si dolli pra ay,  
 Jisuj thotë, Ndashti ulavdurua i Bir' i njeriut,  
 32 edhe Perëndia ulavdurua nd' atë. Ndë ulav-  
 durua Perëndia nd' atë, edhe Perëndia dot'a  
 lavduronjë mbë vetëhet të ti, edhe për-një-  
 33 here dot'a lavduronjë. Djemthit' e mi, edhe  
 pakëzë jam bashkë me ju. Dotë më kërkoni;  
 edhe sikundrë u thashë Judhenjet, Se, ku  
 vete unë, ju s' munt të vini, po edhe juve  
 34 ua them ndashti. Një porosi të-re u lë juve,  
 Të doni njëri tjetërinë; sikundrë un' u desha  
 35 juve, edhe ju të doni njëri tjetërinë. Prej  
 kësaj dot' u njohëuë juve të-gjithë, se jeni  
 nxënësit' e mi, ndë qoftë se kini dashuri  
 njëri mbë tjetërinë.

36 Simon Pjetri i thotë, Zot, ku vete? Jisuj  
 i upërgjeq, *Atje* ku vete *unë, ti* s' munt ndashti  
 të më vinjç prapa; po pastaj dotë më vinjç  
 37 prapa. Pjetri i thotë, Zot, përse nukë munt  
 të të vinj prapa ndashti? jetënë t' ime dot'a  
 38 vë për ty. Jisuj i upërgjeq, Jetënë t' ende  
 dot'a vësh për mua? Me të-vërtetë, me të-  
 vërtetë po të them ty, Nukë dotë këndonjë  
 gjeli, gjersa të më mohonjç tri herë.

#### Kye 14.

1 Letë mos trumbullonetë zëmëra juaj; besoni  
 2 Perëndisë, besoni edhe mua. Ndë shtëpi të  
 t' im Eti ka shumë të-ndënjura; ndë mos, dot' u

- thoshnjam juve, Vete t' u bënj juve gati vënt.
- 3 Edhe si të vete e t' u bënj juve gati vënt, *dotë*  
vinj përsëri, edhe dot' u marr juve për anë  
vetëhesë s' ime, që të jeni edhe ju *atje* ku jam
- 4 unë. Edhe ku vete unë e dini edhe udhën' e dini,
- 5 Thomaj i thotë, Zot, nuk' e dimë se ku  
6 vete; edhe si munt t' a dimë udhënë? Jisuj i  
thotë, Unë jam udha edhe e-vërteta edhe  
jeta; asndonjë s' vjen tek Ati, veç me anë
- 7 t' ime. Ndë qoftë se më njihnitë mua, dotë  
n njihnitë edhe t' im Atë: edhe që ndashti e  
n njihni, edhe e kini parë.
- 8 Filippi i thotë, Zot, dëfte-na Atinë, edhe na  
9 është mjaft. Jisuj i thotë, Kaqë kohë jam  
bashkë me ju, edhe s' më ke njohurë, Filipp?  
ay që më ka parë mua, ka parë Atinë; edhe
- 10 qyç thua ti, Dëfte-na Atinë? Nukë beson  
se unë *jam* tek Ati, edhe Ati është tek unë?  
fjalëtë që u flas unë juve, nuk' jarë prej ve-  
tiu; po Ati që rri tek unë, ay bën punëratë.
- 11 Beso-më-ni se unë *jam* tek Ati, edhe Ati  
është tek unë; ndë mos, beso-më-ni për vetë  
12 punëratë. Me të vërtetë, me të vërtetë po u  
them juve, Ay që më beson mua, dotë bënjë  
edhe ay punëratë që bënj unë, edhe dotë bë-  
një edhe më të mëdha se këto; sepse unë vete
- 13 tek im Atë. Edhe ç' të lypni mb' emërit' im,  
14 dot' a bënj, që të lavduronetë Ati te Biri. Ndë  
lypçi gjë mb' emërit' t' im, unë dot' a bënj.
- 15 Ndë më doni, ruani porosit' e mia.

16 Edhe unë dot' i lutem Atit, edhe dot' u apë juve  
*një* tjatër Ngushullimtar, që të mbetetë bashkë  
17 me ju për *gjithë* jetënë, Frymën e së-vërte-  
tësë, të-cilënë bota s' munt t' a marrë, sepse  
nuk' e sheh, as nuk e njeh; po ju e njihni,  
sepse mbetetë bashkë me ju, edhe dotë jetë  
18 ndër ju. Nukë dot' u lë juve të-varfërë; *dotë*  
19 vinj te ju. Edhe pak, edhe bota nukë më sheh  
më; po ju më shihni; sepse unë rronj, edhe ju  
20 dotë rroni. Nd' atë ditë ju dot' a njihni, se  
unë *jam* tek im Atë, edhe ju tek unë, edhe  
21 unë te ju. Ay që ka porosit e mia edhe i ruan,  
ky është' ay që më do; edhe ay që më do,  
dotë duhetë prej t' im Eti; edhe unë, dot' a  
dua, edhe dotë dëftenj vetëhenë t' ime tek ay.  
22 I thotë Judha (jo Iskarioti,) Zot, ç' ubë që  
dotë dëftenjç vetëhenë t' ende te neve, e jo  
23 te bota? Jisuj upëgjeq e i tha, Ndë më do  
ndonjë, fjalënë t' ime dot' a ruanjë, edhe im  
Atë dot' a dojë, edhe dotë vijnë tek ay, edhe  
24 dotë bëjmë të ndënjurë tek ay. Ay që s' më do,  
fjalët e mija nuk' i ruan, edhe fjala që dë-  
gjoni, nuk' ështëë imja, po e Atit që më dër-  
25 goj. Këto u fola juve, gjersa gjëndem bashkë  
26 me ju. Po Ngushullimtari, Frym e-Shënjtëru-  
arë, të cilënë Ati dot' a dërgonjë mb' emërit  
t' im, ay dot' u mësonjë juve të-gjitha eë dot' u  
bierë juve ndër mënt gjithë sa u kam thënë  
27 juve. Paqtim po u lë juve, paqtimnë t' im po  
u ap juve; jo sikundrë e ep bota, u' a ap

juve. Letë mos trumbulonetë zëmra juaj, as të  
 28 mos frikësonetë. Dëgjuatë se un' u thasë juve,  
 Vetë edhe *dotë* vinj *prapë* te ju. Po të më  
 donitë, dotë gëzonestitë se (thashë), Vete tek  
 Ati; sepse im Atë është më i-math se unë.  
 29 Edhe ndashti u thashë juve, përpara se të  
 30 bënetë, që të besoni kur të bënetë. Më nukë  
 dotë flas bashkë me ju; sepse po vjen ur-  
 dhërtari i kësaj bote, edhe nukë ka të bënë  
 31 asgjë me mua. Po që të njohë bota, se dua  
 Atinë, edhe sikundrë më porositi Ati, kështu  
 bënj. Ngrihi, letë shkojmë së-këtejmi.

#### Krye 15.

1 Unë jam veshti i-vërtetë, edhe im Atë  
 2 është bujku. Çdo hardhi që nukë bie pe-  
 më, e këput; edhe çdo që bie pemë, e qëron,  
 që të bierë më tepërë pemë.  
 3 Ndashti ju jeni të-qëruarë, për fjalënë që  
 4 u kam folurë juve. Mbetuni tek unë, edhe  
 unë te ju. Sikundrë hardhia s' munt të bë-  
 një pemë prej vetiu, ndë mos mbettë ndë  
 veshtët, këstu as ju, ndë mos mbeçi tek unë.  
 5 Unë jam veshti, ju *jeni* hardhitë; ay që  
 mbetetë tek unë, edhe unë tek ay, ky bën  
 pemë shumë; sepse pa mua s'munt të bëni  
 6 asgjë. Ndë mos mbettë ndonjë tek unë, hi-  
 dhetë jashtë posi hardhia, edhe thahetë; pas-  
 taj i mbledhën' e i hedhënë ndë zjarr, edhe  
 7 digjenë. Ndë mbeçi tek unë, edhe fjalët' e

mia ndë mbeçinë te ju, dotë lypni ç'të doni,  
8 edhe dot' u bënetë juve. Im Atë ndë këtë  
lavduronetë, të bini shumë pemë; edhe *kështu*  
dotë jini nxënës të mi.

9 Sikundrë më deshi Ati, edhe un' u desha  
10 juve; mbetuni ndë dashurit t'ime. Ndë ruajçi  
porosit' e mia, dotë mbeteni ndë dashurit t'  
ime; sikundrë unë ruajta porosit' e t'im Eti,  
11 edhe mbetem ndë dashurit t'ati. U fola juve  
këto, që të mbetetë gëzimi im mbë ju, edhe  
gëzimi juaj të jet' i-plottë.

12 Këjo është porosia ime, të doni njëri tja-  
13 tërinë, sikundrë un' u desha juve. Asndonjë  
s'ka dashuri më të-madhe se këtë, të vërë  
14 ndonjë jetën' e ti për miqt' e ti. Ju jini miqt'  
e mi, ndë qoftë se bëni sa u porosit juve.  
15 Nuk' u them juve më shërbëtorë, sepse shër-  
bëtori nukë di se ç'bën i zoti; po u thashë  
juve miq, sepse u dëfteva juve gjithë sa dë-  
16 gjova prej t'im Eti. Ju nukë më sgjohtë mua,  
po un' u sgjodha juve, edhe u urdhërova juve  
të shkoni e të bëni pemë, edhe pema juaj  
të mbesë; që çdo që t' i lypni Atit mb' emë-  
17 rit t'im t'u'a apë juve. Këto u porosit juve,  
të doni njëri tjatërinë.

18 Ndë u ka mëri juve bota, di-e-ni se mua  
19 më ka pasurë mëri me përpara se juve. Të  
ishitë prej botësë, bota dotë donte të-sajnë;  
po me-qënë-që nukë jini nga bota, po un' u  
sgjodha juve nga bota, përandaj u ka mëri

- 20 juve bota. Mbani mënt fjalënë që u thashë unë juve, Nukë ka shërbëtuar më të-math se i zoti. Ndë ndoqnë mua, dot' u ndjekënë edhe juve; ndë ruajtnë fjalënë t'ime, dotë
- 21 ruanjënë edhe t'uajnë. Po të-gjitha këto dot' u'a bënjënë juve për emërinë t'im, sepse nuk' e dinë atë që më dërgoj.
- 22 Të mos kishnjam ardhurë e të mos u kishnjam folur' atyre, nukë dotë kishinë faj; po ndashti nukë kanë ç'të thonë për fajin'
- 23 e tyre. Ay që më ka mëri mua, e ka mëri
- 24 edhe t'im Atë. Të mos kishnjam bërë ndër ata ato punë që s' i ka bërë asndonjë tjatërë, nukë dotë kishinë faj; po ndashti edhe panë, edhe *na* patnë mëri edhe mua edhe t'im Atë.
- 25 Po *këjo ubë*, që të mbushetë fjala që është shkruarë ndë nomt t'atyreve, „Më patnë mëri pa ndonjë farë punë.“
- 26 Po kur të vinjë Ngushullimtari, të-cilinë dot' u'a dërgonj unë juve prej Atit, Fryma e së-vërtetësë, që del nga Ati, ay dotë dëshmonjë për mua. Po edhe ju dëshmoni, sepse që ndë kryet jeni bashkë me mua.

## Krye 16.

- 1 U tola juve këto, që të mos skandhali-
- 2 seni. Dot' u nxjerrënë juve nga sinagogjitë; vërtet vjen një orë ndë të-cilët kushdo që t' u vrasë juve dotë pandehnjë se i shërben
- 3 Perëndisë. Edhe këto dot' u'a bënjënë juve,



- 4 sepse nukë e njohë Atinë, as mua. Po u fola juve këto, që t' i sillni ndër mëntt, kur të vinjë ora, se un' u'a thashë juve. Edhe nuk' u'a thashë juve këto që ndë kryet, sepse ishnjam bashkë me ju.
- 5 Po ndashti po vete tek ay që më dërgoj, edhe asndonjë prej jush s' më pyet, Ku vete?
- 6 Po sepse u fola juve këto, hidhërimi mbushi zëmërenë t' uaj.
- 7 Po unë po u them juve të-vërtetënë, se është mirë për ju të shkonj unë; sepse ndë mos shkofsha, Ngushullimtari nukë dotë vi-
- 8 një te ju. Edhe ay kur të vinjë, dotë qërtonjë botënë për faj, edhe për drejtëri, edhe
- 9 për gjyq; Për faj, sepse nukë më bësonjënë;
- 10 Edhe për drejtëri, sepse vete tek im Atë,
- 11 edhe më nukë më shihni; Edhe për gjyq, sepse urdhërtari i kësaj bote është gjykuarë.
- 12 Edhe shumë u kam për të thënë juve, po
- 13 ndashti nukë munt t' i mbani; Po kur të vinj' ay, Frym' e së-vërtetësë, dot' u heqnjë juve udhënë mbë gjithë të-vërtetënë; sepse nukë dotë flasë prej vetiu, po dotë flasë sa që të dëgjonjë, edhe dot' u dëftenjë juve ato *pu-*
- 14 *nëra* që kanë për të ardhurë. Ay dotë më lavduronjë, sepse prej s' imesë dotë marrë,
- 15 edhe dot' u dëftenjë juve. Gjithë sa ka Ati, janë të mijatë; përandaj thashë, se dotë marrë prej s' imesë, edhe dot' u dëftenjë juve.
- 16 *Edhe* pak, edhe nuke *dotë* më shihni; edhe

- përsëri *edhe* pak, edhe dotë më shihni; sepse unë po vete tek Ati.
- 17 Atëhere *ca* nga nxënësit' e ati i thanë njëri tjetrit, Ç' është këjo që na thotë, *Edhe* pak, edhe nukë dotë më shihni; edhe përsëri *edhe* pak, edhe dotë më shihni? edhe se unë
- 18 vete tek Ati? Thoshinë pra, Ç' është këjo që thotë, *Edhe* pak? Nukë dimë se ç' flet.
- 19 Jisuj pra kupëtoj, se doninë t'a pyesënë, edhe u tha atyre, Për këtë haheni njëri me tjetërinë, se thashë, *Edhe* pak, edhe nukë dotë më shihni, edhe përsëri, *edhe* pak, edhe dotë më
- 20 shihni? Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve, se ju dotë qani, edhe dotë ulërinë, po bota dotë gëzonetë; edhe ju dotë hidhërohi, po hidhërimi juaj dotë kthenetë mbë gëzim.
- 21 Gruaja, kur pjell, ka hidhërim, se i erdhi ora; po si të pjellë foshnjën, s' kujton më shtrëngimnë, për gëzimnë se njeri lindi ndë botët.
- 22 Edhe ju pra ndashti kini hidhërim; po përsëri dot' u shoh juve, edhe zëmëra juaj dotë gëzonetë, edhe asndonjë nukë ngre gëzimnë t' uaj prej jush. Edhe nd' atë ditë nukë dotë lypni prej meje asgjë. Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve, se sa t' i lypni
- 24 Atit mb' emërit t' im, dot' u'a apë juve. Gjer ndashti nukë lyptë asgjë mb' emërit t' im; lypni, edhe dotë merrni, që të jetë i-plottë gëzimi juaj.
- 25 U fola juve këto me të-përgjajtura; po

vjen një orë, kur nukë dot' u flas më juve  
 me të-përgjajtura, po faqeza dot' u dëftenj  
 26 juve për Atinë. Nd' atë ditë dotë lypni mb'  
 emërit t' im; edhe nuk' u them juve, se dot'  
 27 i lutem Atit për ju; Se vetë Ati u do juve,  
 sepse ju më keni dashurë, edhe keni besu-  
 28 arë, se unë dolla prej Perëndisë. Dolla prej  
 Atit, edhe erdha ndë botët; përsëri lë botënë,  
 edhe vete tek Ati.

29 Nxënësit' e ati i thonë, Na ndashti tek  
 flet faqeza, edhe nukë thua asndonjë të-për-  
 30 gjajturë. Ndashti e njohëmë se i di të-gjitha,  
 edhe s' ke nëvojë të të pyesë ndonjë. Përan-  
 daj besojmë se dolle nga Perëndia.

31 Jisuj u upërgjeq atyre, Ndashti besoni?  
 32 Na tek vjen një orë, edhe ndashti erdhi, që  
 të përndaheni gjithë-sicili mbë të-tiat, edhe  
 të më lini vetëmë; po s' jam vetëmë, sepse  
 33 Ati është bashkë me mua. U fola juve këto,  
 që të keni paqtim mbë mua. Ndë botët dotë  
 keni shtrëngim; po kini zëmërë, un' e kam  
 mundurë botënë.

### Krye 17.

1 Këto foli Jisuj; pastaj ngriti syt' e ti ndë  
 qiellt, e tha,

Atë, erdhi ora, lavduro t' ët Bir, që të të  
 2 lavduronjë edhe yt Bir; Sikundrë i dhe pu-  
 shtet mbë çdo mish, që t' u apë jetë të-për-  
 3 jetësme gjith' atyreve që j'a ke dhënë. Edhe

këjo është jet' e-përjetëshme, të njohënë ty të-vetëminë e të-vërtetinë Perëndi; edhe Jisu 4 Krishtinë që dërgove. Unë të lavdurova mbi dhet; atë punë që më dhe të bënj e mba- 5 rova. Edhe ndashti lavduro-më ti, o Atë, për anë teje, me lavdinë që pata për anë teje para se të bënej bota.

6 Emërinë t'ënt u'a dëfteva njerëzet që më dhe prej botësë. Të-tutë ishinë, edhe m' i 7 dhe, edhe fjalënë t' ende e ruajtnë. Ndashti e njohinë se gjithë sa më ke dhënë janë prej 8 teje; Sepse fjalëtë që më dhe, u'a dhashë atyre; edhe ata i muarnë, edhe e njohinë me të-vërtetë se prej teje dolla; edhe bësuanë se 9 ti më dërgove. Unë lutem për ata; nukë lutem për botënë, po për ata që më dhe; sepse 10 janë të-tutë. Edhe gjithë të-mijatë janë të-tuatë, edhe të-tuatë janë të-mijatë; edhe u- 11 lavduruashë nd' ato. Edhe nukë jam më ndë botët, po këta janë ndë botët, edhe unë po vinj te ti. At' i-shënjtëruarë, ruaj-i mb' emërit t' ënt ata që më dhe, që të jenë një si- 12 kundrë neve. Kur ishnjam bashkë me ata ndë botët, un' i ruanjam mb' emërit t' ënt; ata që më dhe i ruajta, edhe asnjë nga ata s' humbi, veç i bir' i humbjesë, që të mbu- 13 shetë shkronja. Edhe ndashti po vinj te ti, edhe flas këto ndë botët, që të kenë gëzimrë 14 t'im të-plottë ndë vetëhet të tyre. Un' u dhash' atyre fjalënë t' ende; edhe bota i mori mëri,

sepse nukë janë nga bota, sikundrë unë nukë  
 15 jam nga bota. Nukë të lutem t' i ngresh ata  
 16 nga bota, po t' i ruanjç nga i-ligu. Nukë  
 janë nga bota, sikundrë unë nukë jam nga  
 17 bota. Shënjtëro-i ata me të-vërtetënë t' ende;  
 18 fjala jote është e-vërteta. Sikundrë më dër-  
 gove mua ndë botët, edhe un' i dërgova ata  
 19 ndë botët. Edhe unë për ata shënjtëronj ve-  
 tëhenë t' ime, që të jenë edhe ata të-shënjtëru-  
 20 arë me të-vërtetënë. Edhe nukë të lutem vetë-  
 më për këta, po edhe për ata që dotë më be-  
 21 sonjënë mua me anë të fjalës' s' atyreve; Që  
 të-gjithë të jenë një; sikundrë ti, o Atë, *je*  
 tek unë, edhe unë tek ti, edhe ata të jenë një  
 te neve; që të besonjë bota se ti më dërgove.  
 22 Edhe un' u dhashë atyre lavdinë që më dhe, që  
 23 të jenë një, sikundrë edhe neve jemi një. Unë  
 tek ata, edhe ti tek unë, që të jenë të-sosurë  
 mbë një, edhe bota t'a njohë se ti më dërgove,  
 edhe se i deshe ata sikundrë më deshe mua.  
 24 O Atë, dua të jenë bashkë me mua *atje*  
 ku jam unë edhe ata që më dhe; që të  
 vështronjënë lavdinë t' ime, që më ke dhënë,  
 sepse më deshe para se të ngrihetë bota .  
 25 O At' i-drejtë, bota nukë të njohu, po unë  
 të njoha, edhe këta e njohën se ti më dër-  
 26 gove. Edhe u dëftova atyre emërinë t' ënt,  
 edhe dot'a dëftenj, që të jetë ndër ata da-  
 shuria, me të-cilënë më deshe, edhe unë tek  
 ata .

## KÛE 18.

- 1 Jisuj passi tha këto, dolli bashkë me nxënësit' e ti përtej përroit të Qedhronit, ku ishte një kopësht, ndë të-cilët hyri ay edhe nxënësit' e ati.
- 2 Edhe e dinte vëndinë edhe Judha, ay që e trathëtoj; sepse Jisuj shumë herë umbloth
- 3 atje me nxënësit' e ti. Judha pra, passi mori tufën' e ushtëtorëvet, edhe shërbëtorë nga kryepriftërit' e nga Farisenjtë, vjen atje me
- 4 fenerë e me pishtarë e me armë. Jisuj pra dyke diturë gjithë ç' dotë vininë mbi atë, dolli,
- 5 e u tha atyre, Cilinë kërkoni? I upërgjeqnë, Jisu Nazoreasinë. Jisuj u thot' atyre, Unë jam. Edhe bashkë me ata rrinte edhe Judha, ay
- 6 që e trathëtoj. Passi pra u tha atyre, Se unë
- 7 jam, uhoqnë prapa, edhe ranë përdhe. Përsëri pra i pyeti, Cilinë kërkoni? Edhe ata
- 8 thanë, Jisu Nazoreasinë. Jisuj upërgjeq, U thashë juve, se unë jam. Ndë më kërkoni mua
- 9 pra, lini këta të venë; Që të mbushetë fjala që tha, Se prej atyre që më dhe nukë humba asnjë.
- 10 Atëhere Simon Pjetri, i-cili kishte një thikë, e hoqi, e i ra shërbëtorit të kryepriftit, edhe i preu ati veshn' e-djathtë; edhe emër' i
- 11 shërbëtorit ishte Mallko. Jisuj pra i tha Pjetrit, Vër'-e thikënë t' ende ndë millr. Kupënë që më dha Ati të mos e pi?
- 12 Tufa e ushtëtorëvet pra edhe urdhërmi-

jësi edhe shërbëtorët' e Judhenjvet zunë Jisunë, edhe e lithnë, edhe e shpunë atë më përpara  
13 te Anna; Sepse ish i vjehëri i Kaiafësë, i-cili  
14 ishte kryeprift i ati viti. Edhe Kaiafa ishte ay që këshilloj Judhenjtë, se është mirë të humbasë një njeri për llauzinë.

15 Edhe Simon Pjetri i vinte prapa Jisujt, edhe ay nxënësi tjetërë; edhe ay nxënësi ishte i-njohurë te kryeprifti, edhe hyri bashkë me Jisunë ndë avllit të kryepriftit. Po Pjetri rrinte jashtë për anë derësë. Dolli pra ay nxënësi tjetërë që ishte i-njohurë te kryeprifti, edhe i tha portaresë, edhe e kalli brenda Pjetrinë. Atëhere shërbëtoreja portare i thotë Pjetrit, Mos je edhe ti nga nxënësit'e  
16 këti njeriu? Ay i thotë, Nukë jam. Edhe punëtorët' edhe shërbëtorëtë kishinë bërë zjarr, sepse ishte ftohëtë, edhe po ngroheshinë; edhe bashkë me ata ishte edhe Pjetri dyke ndënjur' e dyke ngrohurë.

19 Kryeprifti pra pyeti Jisunë për nxënësit' e  
20 ati edhe për mësimn' e ati. Jisuj i upërgjiej, Unë faqeza fola ndë botët; unë përhere mësova *njerëzitë* ndë sinagogjit edhe ndë hieroret, ku nga të gjithë anëtë mblidhenë Judhenjtë, edhe mbë të-fshehëtë nukë fola as  
21 gjë. Ç' me pyet? pyet ata që kanë dëgjuarë ç' ufolatyre; na këta dinë sa thash' unë.

22 Edhe ay kur tha këto, një nga shërbëtorëtë që rrinte për anë i ra një shuplakë Jisujt

- dyke thënë, Kështu i përgjigjesh kryepriftit?
- 23 Jisuj i upërgjeq, Ndë fola keq, dëshmo për të-keqenë; po ndë *fol*a mirë, përse më rreh?
- 24 Edhe Anna e dërgoj lidhurë te kryeprifti Kaiafë.
- 25 Edhe Simon Pjetri ishte dyke ndënjurë edhe dyke ngrohurë; i thanë pra, Mos je edhe ti nga nxënësit' e ati? Ay e mohoj, e
- 26 tha, Nukë jam. Një nga shërbëtorët' e kryepriftit, që ishte farëfisas i ati, të-cilit Pjetri i preu veshnë, thotë, Nukë të pash' unë ndë
- 27 kopështtt bashkë me atë? Pjetri pra e mohoj përsëri, edhe për-ñë-here gjeli këndo.
- 28 Bienë pra Jisunë prej Kaiafësë ndë vëntt të gjyqit; edhe ishte mëngjes, edhe ata nukë hynë ndë vëntt të gjyqit, që të mos ndyrenë, po të hanë pashkënë.
- 29 Pillati pra dolli, edhe tha, Ç'farë përfolje-
- 30 je bini kundrë këti njeriu? Upërgjeqn' e i thanë, Ky të mos ishte keq-bërës, nukë dotë
- 31 t'a epnimë ty ndër duar. Pillati pra u tha atyre, Merr-e-ni ju edhe pas nomit t'uaj gjyko-e-ni. Judhenjtë pra i thanë, S' është'e-ndjerë
- 32 ndër ne të vrasëmë asnjeri. Që të mbushetë fjal' e Jisujt që tha, dyke shënuarë me ç'farë vdekjeje kishte për të vdekurë.
- 33 Pillati pra hyri përsëri ndë vëntt të gjyqit, edhe thërriti Jisunë, e i tha, Ti je mbretti i Judhenjet? Jisuj upërgjeq, Prej vetiu e
- 34 thua ti këtë, apo të-tjerë të thanë për mua?



35 Pillati upërgjeq, Mos jam unë Judhe? kom-  
 bi yt edhe kryepriftëritë të dhanë ndër du-  
 36 art t' ime; ç' ke bërë? Jisuj upërgjeq, Mbretë-  
 ria ime nuk' është prej kësaj bote; mbretë-  
 ria ime po të qe prej kësaj bote, shërbë-  
 torët' e mi dotë përpiqeshinë, që të mos e-  
 pem ndë duart të Judhenjvet. Po tashi mbretë-  
 37 ria ime nuk është së-këtejmi. Pillati pra i  
 tha, Mbret je ti pra? Jisuj upërgjeq, Ti po  
 thua, se unë jam mbret. Unë përandaj linda,  
 edhe përandaj erdha ndë botët, që të dësh-  
 monj për të-vërtetënë. Kushdo që është prej  
 38 së-vërtetësë, dëgjon zënë t'im. Pillati i thotë,  
 Ç' është e-vërteta?

Edhe si tha këtë, doli përsëri te Judhenj-  
 të, e u thot' atyre, Unë nukë gjenj ndonjë faj  
 39 tek ay. Po është zakon ndër ju, t'u lëshonj  
 juve një për pashkë; doni pra t'u lëshonj  
 40 juve mbretin'e Judhenjvet? Atëhere të-gjithë  
 bërtitnë përsëri, dyke thënë, Mos këtë, po  
 Varavvanë. Edhe Varavvaj ishte kursar.

### Krye 19.

1 Atëhere pra Pillati mori Jisunë, edhe e  
 2 rrahu. Edhe ushtëtorëtë gërshetuanë një ku-  
 rorë prej ferrash, e j'a vunë mbi kryet, edhe  
 3 i veshnë një rrobë të-kuqe, Edhe thoshinë,  
 Gëzohu, o mbret' i Iudhenjvet! edhe i bininë  
 me shuplaka.  
 4 Pillati pra doli përsëri jashtë, edhe u thot'

- atyre, Na tek po u'a bie atë jashtë, që t'a  
5 dini, se asndonjë faj nukë gjenj tek ay. Jisuj pra dolli jashtë veshurë kurorënë prej ferrash edhe rrobën' e-kuqe. Edhe *Pillati*  
6 u thot' atyre, Na njeriu! Kur e pan' atë kryepriftërit' edhe shërbëtorëtë, bërtitnë, dyke thënë, Kryqëzo-e, kryqëzo-e. Pillati u thot' atyre, Merr-e-ni ju atë, edhe kryqëzo-e-ni;  
7 sepse unë nukë gjenj faj tek ay. Judhenjtë i upërgjeqnë, Neve kemi nom, edhe pas nomit t'ënë ky duhetë të vdesë, sepse bëri vetëhen' e ti Bir të Perëndisë.
- 8 Pillati pra kur dëgjoj këtë fjalë, më te-  
9 përë ufrikësua, Edhe përsëri hyri ndë vëntt të gjyqit, edhe i thotë Jisujt, Nga je ti? Po  
10 Jisuj nuk' i dha të-përgjegjurë. Pillati pra i thotë, Mua nukë më flet? nuk' e di *ti se unë* kam pushtet të të kryqëzonj, edhe kam pu-  
11 shtet të të lëshonj? Jisuj upërgjeq, Nukë *dotë* kishnje asndonjë pushtet kundrë meje, po të mos të qe dhënë prej së-larti; përandaj ay që më ep ndër duart të tua ka më të-math faj.
- 12 Që atëhere Pillati kërkonte t' a lëshonte, po Judhenjtë thërrisninë dyke thënë, Ndë lëshofsh këtë, nukë je miku i Qesarit; gjithëkush që bën vetëhen' e ti mbret, flet kundrë Qesa-  
13 rit. Pillati pra kur dëgjoj këtë fjalë, solli jashtë Jisunë, edhe ndënji mbi front të gjyqit, që thuhetë Gur-shtruarë, edhe Evraisht Gavvatha.

14 Edhe ishte kanon' i pashkësë, edhe ora  
sindonja gjashtë; edhe u thot' Judhenjvet, Na  
15 mbreti juaj. Po ata bërtitnë, Ngri-*e*, ngri-*e*,  
kryqezo-*e*. Pillati u thot' atyre, Mbretinë t' uaj  
të kryqëzonj? Kryepriftërit' upërgjeqnë, S' ke-  
16 mi *tjatërë* mbret veç Qesarinë. Atëhere pra  
u'a dha atyre ndër duar, që të kryqëzonetë.  
Edhe *ata* muarnë Jisunë, edhe e shpunë.

17 Edhe *Jisuj* dyke mbajturë kryqin' e ti dolli  
nd' *atë* vënt që thuhetë vënd' i Kresë, që  
18 Evraisht thuhetë Gollgotha; Atje kryqëzuan'  
atë edhe dy të-tjerë bashkë me atë andej  
edhe këtej, edhe Jisunë ndë mest.

19 Pillati shkroj edhe një titllë, edhe e vuri  
mbi kryqt; edhe ishte shkruarë *Jisu Nazo-*  
20 *reasi mbreti i Judhenjvet*. Edhe këtë titllë e  
kënduanë shumë *veta* prej Judhenjet; sepse  
ishte shkruarë Evraisht, Gërquisht *edhe* Lla-  
21 tinisht. Edhe kryepriftërit' e Judhenjvet pra i  
thoshinë Pillatit, Mos shkruaj, Mbreti i Ju-  
dhenjvet, po se ay tha, Jam mbreti i Judhenj-  
22 vet. Pillati upërgjeq, Atë që shkrova e shkrova.

23 Ushtëtorëtë pra, passi e kryqëzuanë Ji-  
sunë, muarnë rrobat' e ati, edhe i bënë katrë  
pjesë, për gjithë-si-cilinë ushtëtuar një pje-  
së, edhe petkunë; edhe petku ishte i-paqe-  
24 purë, endur' i-tërë që së-sipërmi. Thanë pra  
ndër mest të tyre, Letë mos e grismë atë,  
po letë shtjemë shortë për atë, kujt t' i bjerë;  
—që të mbushetë shkronja që thotë, „Ndanë

rrobat' e mia ndër mest të tyre, edhe shtynë shortë mbi petkunë t' im." Ushëtoretë pra bënë këto.

25 Edhe për anë kryqit të Jisujt ishinë dyke ndënjurë e ëma edhe e motër' e s' ëmës s' ati, Maria *gruaja* e Killopajt, edhe Maria Mag-  
26 dhalinë. Jisuj pra kur pa t' ëmënë edhe *atë* nxënësinë që donte dyke ndënjurë për anë,  
27 i thotë s' ëmësë, Grua, na yt bir. Pastaj i thotë nxënësit, Na jot' ëmë. Edhe nxënësi që atëhere e mori ndë shtëpit të ti.

28 Pas kësaj Jisuj dyke diturë, se ndashti umbaruanë të-gjitha, që të mbushetë shkro-  
29 nja, thotë, Kam et. Edhe ishte *atje* një enë plot me uthullë; edhe ata mbushnë një siungar me uthullë, edhe e vunë mbë një hyssop,  
30 e j'a prunë ndë gojë. Jisuj pra kur mori uthullënë, tha, Umbarua, edhe unji kryetë, e dha frymënë.

31 Judhenjtë pra, për të mos mbeturë trupatë mbi kryqt për *ditën'* e-shëtunë, sepse ishte e-prëmte, (sepse ajo dit' e-shëtunë ishte e-madhe,) i ulutnë Pillatit t' u thyhenë kërcinj't e *këmbëvet*, edhe të ngrihen' *andej*. Erthnë pra ushtëoretë, edhe thyenë kërcinj't e të-parit, edhe t' ati tjetërit që ukryqëzua  
33 bashkë me atë. Po kur erthnë te Jisuj, edhe e panë, se më kishte vdekurë, nuk' i thye-  
34 në kërcinj'të; Po një nga ushtëoretë i çpoj brinjënë me shtijzë, edhe për-një-here i doli

35 gjak edhe ujë. Edhe ay që pa dëshmoj, edhe  
dëshmim' i ati është' i-vërtetë, edhe ay e di  
36 se thotë të-vërtetënë, që të besoni ju. Sepse  
këto ubënë që të mbushetë shkronja, „Eshtër  
37 nukë dot' i thyhetë.“ Edhe përsëri një tjetërë  
shkronjë thotë, „Dotë vështronjënë mb'atë qe  
çpuanë.“

38 Edhe pas këtyre Josifi që ishte nga Ari-  
mathea, (i-cili ishte nxënës i Jisujt, po i fshe-  
hurë nga frik'e Judhenjvet,) i ulut Pillatit që  
të ngrerë trupin' e Jisujt; edhe Pillati i dha  
lejë. Erdhi pra edhe ngriti trupin' e Jisujt.  
39 Erdhi edhe Nikodhimi, (ay që pat ardhurë  
te Jisuj një herë më parë natënë,) edhe pruri  
të-përzjerë mirë edhe alloe, sindonja një qint  
40 litra. Muarnë pra trupin' e Jisujt, edhe e-  
pshtuallnë me pëlhurëra bashkë me erëratë,  
sikundrë e kanë zakon Judhenjtë të kllasënë  
ndë varr.

41 Edhe nd' atë vënt që ukryqëzua ishte një  
kopësht, edhe ndë kopështtt një varr i-ri, ndë  
42 të-cilët edhe s' ishtë vënë asndonjë *njeri*. Atje  
pra vunë Jisunë, për të-prëmtën' e Judhenjet,  
sepse varri ishte afërë.

### Krye 20.

1 Edhe *ditën'* e-parë të javësë vjen Maria  
Magdhalinë te vari ndë mëngjest, dyke qënë  
edhe po errëtë, edhe sheh gurinë ngriturë  
2 nga varri. Suletë pra edhe vjen te Simon,

Pjetri, edhe tek *ay* nxënësi tjetërë që donte Jisuj, edhe u thot' atyre, E ngritnë Zotinë nga varri, edhe nukë dimë se ku e kanë vënë.

3 Dolli pra Pjetri edhe nxënësi tjetërë, edhe  
4 vininë ndë varrt. Edhe suleshinë të dy bashkë;  
edhe *ay* nxënësi tjetërë usul përpara më  
çpejt se Pjetri edhe erdhi më përpara ndë  
5 varrt; Edhe si uunj, sheh pëlhuratë ku ishinë,  
6 po nukë hyri. Vjen pra Simon Pjetri dyke  
ardhurë pas ati, edhe hyri ndë varrt, edhe  
7 vë re pëlhuratë ku ishinë; Edhe riza që ishte  
mbi kryet t' ati nuk' ugjënt bashkë me pël-  
huratë, po ishte pshtjellë veç mbë një vënt.  
8 Atëhere pra hyri edhe *ay* nxënësi tjetërë  
që erdhi më përpara ndë varrt, edhe pa,  
9 edhe besoj; Sepse edhe s'kupëtoninë shkro-  
njënë, se *ay* duhetë të ngjalletë prej së-vde-  
10 kurish. Nxënësitë pra vanë përsëri ndëpër  
shtëpirat të tyre.

11 Edhe Maria rrinte përanë varrit dyke qarë  
përjashta; edhe tek po qante, uunj ndë varrt;  
12 Edhe vë re dy ëngjëj me rroba të-bardha  
dyke ndënjurë njeri nga krej e tjatëri nga  
13 këmbëtë, *atje* ku qe trupi i Jisujt. Edhe ata  
i thonë asaj, Grua, përse qan? U thot' atyre,  
Sepse ngritnë t'im Zot, edhe nukë di ku e  
14 kanë vënë. Edhe si tha këto, ukthye prapa,  
edhe vë re Jisunë dyke ndënjurë, edhe nuk'  
15 e dinte se është Jisuj. Jisuj i tha asaj, Grua,  
përse qan? cilinë kërkon? Po ajo dyke pan-

dehurë, se është kopshtari, i thotë, Zot, ndë  
e ngrite ti, thuaj-më ku eke vënë, edhe unë  
16 dot'a ngre atë.. Jisuj i thot' asaj, Marie! Ajo  
kthenet' e i thotë, Ravuni! që do me thënë,  
17 Mësonjës. Jisuj i thot' asaj, Mos m' upshet;  
sepse edhe s'kam hipurë tek im Atë; po shko  
te vëllezërit' e mi, edhe u thuaj atyre, Po  
hipënj tek im Atë edhe tek Ati juaj, edhe  
18 te Perëndia im edhe te Perëndia juaj. Vjen  
Maria Magdhalinë, e u ep zë nxënëset, se  
pa Zotinë, edhe se i tha asaj këto *fjalë*.  
19 Nd' atë ditë pra, të-parënë *ditë* të javësë,  
si ungrys, edhe dyert' ishinë mbyllur' atje ku  
ishin mbledhurë nxënësitë nga frik' e Judhenj-  
vet, erdhi Jisuj, edhe ndënji ndë mest, edhe  
20 u thot' atyre, Paqtim mbë ju. Edhe si tha  
këtë, u dëfteu atyre duart' edhe brinjën' e ti.  
Ugëzuanë pra nxënësitë, kur panë Zonë.  
21 Edhe Jisuj u tha atyre përsëri, Paqtim mbë  
ju; sikundrë më dërgoj Ati, edhe un' u dër-  
22 gonj juve. Edhe si tha këtë, fryjti, edhe u  
23 thot' atyre, Merni Frymë të-Shënjtëruarë. Kuj-  
ve t' u falni fajetë, u janë falur' atyre; kujve  
t'u'a mbani, u janë mbajtur' atyre.  
24 Po Thomaj, një nga të dy-mbë-dhjetëtë,  
që thuhetë Binjak, nuk' ishte bashkë me ata,  
25 kur erdhi Jisuj. Nxënësit' e-tjerë pra i tho-  
shinë, Pamë Zotinë. Po ay u tha atyre, Ndë  
mos pafsha ndë duart t'ati shënjën' e pero-  
navet, edhe të vë gishtinë t'im ndë shënjët

të peronavet, edhe të vë dorënë ndë brinjët t' ati, s' kam për të besuarë.

- 26 Edhe pas tetë ditsh përsëri ishinë brënda nxënësit' e ati, edhe Thomaj me ata. Vjen Jisuj, ndonëse dyertë ishinë mbyllurë, edhe ndënji ndë mest, edhe tha, Paqtim mbë ju.
- 27 Pastaj i thotë Thomajt, Bierë gishtinë t'ënt këtu, edhe shih duart' e mia; edhe bierë dorënë t'ënde, edhe vër'-e ndë brinjët t'ime,
- 28 edhe mos ubëj i-pabesë, po besëtar. Edhe Thomaj upërgjeq, e i tha, Zoti im edhe Perëndia im. Jisuj i thotë, Sepse më pe, (o Thoma,) besove; lum ata qe nukë panë, edhe besuanë.
- 30 Edhe shumë çudira të-tjera bëri Jisuj përpara nxënëset të ti, të-cilatë nukë janë
- 31 shkruarë ndë këtë vivli. Po këto ushkruanë që të besoni se Jisuj është Krishti, i Bir' i Perëndisë, edhe dyke besuarë të keni jetë mb' emërit t'ati.

### Krye 21.

- 1 Pastaj Jisuj u'a dëfteu vëtëhen' e ti përsëri nxënëset ndë dett të Tiveriadhësë; edhe e dëfteu kështu.
- 2 Ishinë bashkë Simon Pjetri edhe Thomaj që thuhetë Binjak, edhe Nathanaili që është nga Kanaja e Galilesë, edhe të *bijt* e Zevedheut, edhe dy të-tjerë nga nxënësit' e ati.
- 3 Simon Pjetri u thot' atyre, Vete të gjuanj pishqe. I thonë, Vijmë edhe neve bashkë



me ty. Duallnë edhe hipnë ndë lundrët përnjë-here, edhe atë natë nukë zunë asgjë.

4 Po tani si ubë mëngjes, Jisuj ndënji ndë  
buzët të *detit*; po nxënësitë nuk' e njohnë se  
5 është Jisuj. Jisuj pra u thot' atyre, Djemthit'  
*e mi*, mos keni ndonjë gjë për të ngrënë?  
6 I upërgjeqnë, jo. Edhe ay u tha atyre, Hithni  
rrietënë mb' anët të-djathtë të lundrësë, edhe  
dotë gjeni. E hothnë pra, edhe s'muntënë më  
7 t'a hiqninë nga shumica e pishqevet. Ay nxë-  
nësi pra, që donte Jisuj, i thotë Pjetrit, **Është**  
Zoti. Edhe Simon Pjetri, kur dëgjoj se është  
Zoti, upshtuall me petkunë, (sepse iste la-  
8 kuriq,) edhe uhoth ndë dett. Edhe nxënësit'  
e-tjerë erthnë me lundrëzënë, (sepse nuk'  
ishte lark tokësë, po sindonja dy qint kut,)  
dyke hequrë rrietën' e pishqevet.

9 Edhe si sbritnë pra mbë tokët, shohënë,  
se *atje* ishte një zjarr i-ndezurë, edhe një  
10 peshk vënë mbi atë, edhe bukë. Jisuj u thot'  
11 atyre, Bini nga pishqetë që zutë tashi. Simon  
Pjetri hipi edhe hoqi rrietënë mbi tokët plot  
me pishke të mëdhenj, një qint e pesë-dhjet'  
12 e tre. Jisuj u thot' atyre, Ejani e drekoi. Po  
asndonjë nga nxënësitë nukë kuxonte t'a py-  
esë, Cili je ti? sepse e dininë se është Zoti.  
13 Vjen pra Jisuj edhe merr bukënë e u'a ep,  
edhe peshkunë gjithashtu.

14 Këjo është e-treta herë që udëftye tashi

Jisuj te nxënësit' e ti, passi ungjall prej sëvdekurish.

- 15 Passi udrekuanë pra, Jisuj i thotë Simon Pjetrit, Simon *i bir'* i Jonajt, A më do më tepërë se këta? I thotë, Po, Zot; ti e di se
- 16 të dua. I thot' ati, kullot shqerat' e mi. I thotë prapë përsë-dyti, Simon *i bir'* i Jonajt, a më do? I thotë, Po, Zot; ti e di se të dua.
- 17 I thotë, Ruaj dhënt' e mia. I thotë përsë-treti, Simon *i bir'* i Jonajt, a më do? Pjetrit i erth keq, se i tha përsë-treti, A më do? edhe i tha, Zot, ti i di të-gjitha; ti e di se të
- 18 dua. Jisuj i thotë, Kullot dhënt' e-mia. Me tëvërtetë, me tëvërtetë po të them, Kur ishnje *ti* më i-ri, ngjishnje vetëhenë t' ende, edhe ecënje ku të donje; po kur të mblakesh, dotë ndejsh duart' e tua, edhe tjatërë *njeri* dotë të ngjeshnjë ty, edhe dotë të shpjerë
- 19 ku të mos duash. Edhe tha këtë, dyke shënuarë me ç' farë vdekjeje kishte për të lavduruarë Perëndinë.
- 20 Edhe si tha këtë, i thotë, Eja pas meje. Edhe Pjetri ukthye, edhe sheh *atë* nxënësinë që donte Jisuj dyke ardhurë prapa, i-cili ndë darkët i pat rënë mbë krahëruart, e i tha,
- 21 Zot, cili është' ay që të trathëton? Pjetri pra kur pa këtë, i thotë Jisujt, Zot, po ky ç' *dotë*
- 22 *bënetë*? Jisuj i thotë, Ndë dua të mbesë ay gjersa të vinj *unë*, ti ç' *ke*? ti eja pas meje.
- 23 Dolli pra këjo fjalë ndër vëllezërit, se ay

nxënësi nukë vdes. Po Jisuj nuk' i tha, se nukë vdes; po, Ndë dua të mbesë gjersa të vinj *unë*, ti ç' ke?

24 Ky është ay nxënësi qe dëshmon për këto, edhe që shkroj këto; edhe e dimë se dëshmim' i ati është i-vërtetë.

25 Janë edhe shumë të-tjera sa bëri Jisuj, të-cilatë ndë ushkrofshinë një nga një, kujtonj se as bota vetë nukë dot' i nxintë vllatë që ishinë për të shkruarë. Amin.









